

ISSN 1857-6443  
9 771857 644006

2018

Vit i reformave  
dhe i ndry-  
shimit të emrit

Fq.4



SHQIPTARËT  
DHE ARSIMI

Viti i  
plogështisë  
shqiptare në arsim

Fq.6



Shqipërinë  
e çoj në  
Euro 2020

Kristijan  
Panuçi

Fq.25



# Koha

www.koha.mk



"Shqipëria e  
vogël" në  
Nju Jork

Fq.18

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3258 · e shtunë 30 dhjetor- 4 janar 2017-2018

1°C | 7°C

15 DEN

VITI I RI 2018

Shkupi i vogël  
i shqiptarëve



Shqiptarët e Shkupit vazhdojnë të vuajnë për një ndarje të re territoriale. Mbase kjo problematikë i tangon shumë komuna me shumicë shqiptare, një rishqyrtim i dispozitave të Ligjit për ndarje të territorial, doemos duhet të bëhet kur flitet për zhvillimin dhe integrimin e shqiptarëve që jetojnë në kryeqytet dhe rrethinë. Hartimi i komunave dhe njësisive të bashkëqeverisje lokale që u bë në vitin 2004, një pjesë bukur të mirë të vendbanimeve shqiptare....

Fq.5

Një ligj  
ndryshe  
për çmimet  
shtetërore

Fq.7

Të braktisur  
nga shteti

Fq.15

Vit për tu  
mbajtur mend

Fq.23



# GËZUAR 2018



## Korrupsioni nuk shkulet dot

Shkup, 29 dhjetor - Shumica e qytetarëve të Evropës Juglindore nuk janë të kënaqur me situatën në shoqëri, ndërsa ndër problemet kryesore, krahas papunësisë - e theksojnë korrupsionin. Se ky problem është ndër brengat kryesore të qytetarëve në Ballkan e konfirmojnë edhe raportet dhe analizat e ndryshme të institucioneve relevante ndërkombëtare. Bile në vitet e fundit rritet shqetësimi i tyre edhe për

mitmarjen, tregon Barometri Ballkanik i vitit 2017 që analizon opinionin e qytetarëve për situatën në rajon. "Është brengosëse se sipas rezultateve të Barometrit, sa vjen e më shumë rritet frika nga korrupsioni. Në Barometrin e vitit 2015, 15 për qind e të anketuarve ka vlerësuar se korrupsioni parqet një nga problemet kryesore në rajon, ndërsa një vit më vonë, kjo shifër është rritur në 27 për qind..."

Fq.9



## Borxhi i jashtëm i Shqipërisë arrin në 8 miliardë euro

Tiranë, 29 dhjetor - Borxhi i jashtëm i Shqipërisë, publik dhe privat, ka arritur në gati tetë miliardë euro në gjatshëmujorin e parë të vitit. Banka Qendrore e Shqipërisë ka bërë një analizë të detajuar mbi borxhin e jashtëm bruto të vendit, kur rezultoi se në raport me BPV-në, borxhi i jashtëm ka rënë me pesë pikë përqindje, duke arritur në nivelin 70 për qind të BPV-së. Qeveria zë peshën më të madhe në strukturën e borxhit të jashtëm me 43,2 për qind të totalit ose rreth 3,4 miliardë euro. Në raport me BPV-në borxhi i jashtëm qeveritar vlerësohet 30.2 për qind, me rënie 1.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Pas qeverisë në marrjen e borxhit renditen huat ndër kompani të investimeve të huaja direkte, me 22 për qind, të totalit, dhe vazhdojnë huat e korporatave depozituese, borxhi i sektorëve të tjerë dhe ai i autoritetit monetar. Raporti ndërmjet borxhit të jashtëm dhe eksporte tona është në nivelin 183.6 për qind, me rënie krahasuar me një vit më parë. Por Banka e Shqipërisë vlerëson se ky tregues është përsëri mbi pragun kritik prej 150 për qind.

# NUK HIQET DORË NGA SHFUQIZIMI I GJYKATËS SPECIALE



"Ne e kundërshtojmë. E kam kundërshtuar dhe do ta kundërshtoj një gjykatë të tillë sepse nuk është një gjykatë që e dënon krimin, por që kërkon të dënojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin që e ka bërë...", thotë Nait Hasani

Prishtinë, 29 dhjetor - Kërkesa e 43 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, e 22 dhjetorit, për seancë të jashtëzakonshme për shfuqizimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, që njihet si Gjykata Speciale për krime të luftë në Kosovë, do të mbetet edhe më tej dhe ajo do të votohet nëse arrin para deputetëve, thonë deputetë të partive në pushtet dhe atyre opozitare. Nait Hasani, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekt ky brenda koalicionit qeverisës në vend, thotë për Radion Evropa e Lirë se kërkesë për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale është bërë për ndryshimin e karakterit etnik të gjykatës dhe të mos gjykohen vetëm pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por të gjithë ata që kanë bërë krime të supozuara, përfshirë edhe individët e mundshëm nga bashkësitë tjera etnike në Kosovë. "Ne e kundërshtojmë. E kam kundërshtuar dhe do ta kundërshtoj një gjykatë të tillë sepse nuk është një

gjykatë që e dënon krimin, por që kërkon të dënojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin që e ka bërë. Kërkesa ime personale dhe e 43 të nënshkruarve, ka qenë, është dhe do të mbetet si kërkesë drejtuar Kuvendit për shqyrtimin e plotësim ndryshimin e ligjit, nga një Gjykatë Speciale që është tash me Dhomat të Specializuara, të krijohet një gjykatë në Kosovë, e cila do të merret me trajtimin e rasteve të dyshuara për krime edhe të komuniteteve të tjera, sikurse krimet serbe në Kosovë", thotë Hasani. Në anën tjetër, në një intervistë me Radion Evropa e Lirë, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka thënë se "nisma e deputetëve për Gjykatën Speciale nuk është një kërkesë për të sfiduar gjykatën, por është alternativë, sikurse që kanë edhe vendet e tjera të ish-Jugosllavisë: Kroacia, Bosnja dhe Serbia". Vendimi për Gjykatën Speciale i vitit 2015, sipas tij, mbetet në fuqi, por, lidhur me nismën e 43 deputetëve, ndonëse në dy tentime ka dështuar të dërgohet para deputetëve të Ku-

vendit të Kosovës, ai ka thënë, se çështja nuk është mbyllur. Në anën tjetër, partitë opozitare mbeten të ndara në qëndrime lidhur me propozimin e 43 deputetëve për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Lidhja Demokratike e Kosovës, ka deklaruar se është kundër kësaj nisme.

"Kosova dhe institucionet e Kosovës duhet të marrin guximin, jo të propozojnë zhbrerjen e Gjykatës Speciale përmes shfuqizimit të Ligjit, por të marrin përgjegjësinë për trajtimin e krimeve, vrasjeve e torturave që kanë ndodhur në vendin tonë", kishte shkruar ditë më parë kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, në rrjetin social Facebook. Por, Rexhep Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht subjekti më i madh opozitar, e cila në vitin 2015 pati kundërshtuar dhe votuar kundër themelimit të Gjykatës Speciale, thotë për Radion Evropa e Lirë, se qëndrimi i këtij subjekti nuk ka ndryshuar na ai i vitit 2015. Sipas tij, pavarësisht se propozimi ka ardhur nga partitë në pushtet, Lëvizja Vetë-

vendosje vazhdon ta konsiderojë si gjykatë të padrejtë për Kosovën. "Nuk është hera e parë që iniciativat nuk i kemi parë prej nga kanë ardhur, por çfarë janë ato. Po ta kishim parë se prej nga ka ardhur iniciativa, që ka ngelur vetëm iniciativa, për ndryshimet kushtetuese për Forcat e Armatosura, ne do ta votojmë kundër, por ne jemi deklaruar 'për' sepse është interes i Kosovës. Kështu që, prapë të njëjtën qasje do ta kemi. Ne do të jemi kundër kësaj gjykatë dhe do ta manifestojmë me votën tonë në seancë, kurdo që do të vjen", thotë Selimi. Propozimi për shfuqizimin e Gjykatës Speciale ka ngjallur reagime të ashpra të ambasadorëve të vendeve të Quintit. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, e ka cilësuar këtë veprim si "ngulje e thikës pas shpinës ndaj Amerikës". Ndërkaq, ambasadori i Britanisë së Madhe, Ruairi O'Connell, e ka quajtur mbrëmjen e 22 dhjetorit, si "nata më e rrezikshme për Kosovën që nga përfundimi i luftës".

## PREZANTOHEN PROJEKTET PËR ZHVILLIMIN E MEKËS

Meka, 29 dhjetor - Arabia Saudite ka në plan të zbatojë projekte me kapacitet për të pranuar 30 milionë pelegrinë dhe vizita të umreve në Mekë. Sipas lajmit të agjencisë zyrtare të Arabisë Saudite, SPA, në Xhidde u mbajt "Panairi dhe Konferenca e Ndërtimit të Mekës". Në panair morën pjesë institucione dhe organizata nga sektori publik dhe privat, si dhe përfaqësues nga ministrinë dhe institucionet e

sigurisë. Në program, u prezantuan modelet dhe detajet e projekteve përfshirë rindërtimet dhe rregullimi i Mekës për të pranuar kapacitet prej 30 milionë vizitorësh për Umre. Pjesëmarrësit u shprehën se duhen bërë projekte të tilla, si zgjerimi i rrethit të Qabes për të rritur vizitorët e Umres dhe kapacitetin e pelegrinazhit në Mekë sidomos rreth haremit, si dhe njoftuan se do të realizohen

projekte si përtëritja në zonën e energjisë elektrike, ujit dhe sanitares, rritjes së numrit të hoteleve, dyfishimit të sistemeve hekurudhore dhe zgjerimit të aeroportit në Xhidde. U theksua se projektet do të realizohen në kuadër të vizionit të Arabisë Saudite për vitin 2030. Ndryshe, në vitet e fundit, Arabia Saudite mund të përballojë rreth 5 milionë vizitorë të Umres dhe rreth 2 milionë pelegrinë.



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: Adria Media Balkan - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 28 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

BAROMETRI MË I RI GLOBAL I BRIMA GALUP

## OPTIMISTË PËR EKONOMINË



"Gjithsej 36 për qind nga qytetarët e Maqedonisë presin viti 2018-të të jetë me prosperitet ekonomik, 24 për qind vlerësojnë se viti do të jetë me vështirësi ekonomike, ndërsa 34 për qind nuk do të ketë ndryshime", qëndron në Raport

Shkup, 29 dhjetor - Banorët e Maqedonisë janë optimistë në lidhje me prosperitetin ekonomik në vitin 2018, numri më i madh shpresojnë për vit më të mirë, ndërsa ndjehen edhe më të lumtur nga pjesa më e madhe e të anketuarve të tjerë në vendet në botë, tregon Barometri më i ri global i Brima Galup. "Si vitin paraprak, ashtu edhe këtë vit, të anketuarit në Maqedoni tregojnë pritje të mëdha për vitin e ardhshëm 2018-të kur është në pyetje prosperiteti ekonomik që janë më të larta nga mesatarja botërore. Gjithsej 36 për qind nga qytetarët e Maqedonisë presin viti 2018-të të jetë me prosperitet ekonomik, 24 për qind vlerësojnë se viti do të jetë me vështirësi ekonomike, ndërsa 34 për qind nuk do të ketë ndryshime", qëndron në Raport. Në pyetjen "Nëse vlerësoni se viti 2018 do të jetë më i mirë, më i keq apo i njëjtë si viti 2017?", 46 për qind kanë deklaruar se presin që viti i ardhshëm të jetë më i mirë, 18 për qind do të jetë më i keq, ndërsa 31 për qind presin

të mos ketë ndryshime. Neto rezultati arrin +28 për qind që është shumë më i madh nga viti i kaluar i cili arrinte +18 për qind. "Neto rezultati i Lumturisë në Maqedoni arrin +54 për qind që është më i lartë se mesatarja botërore, +48 për qind. Në pyetjen "Nëse personalisht do të ndjeheni shumë të lumtur, të lumtur, as të lumtur e as të palumtur, të palumtur apo shumë të palumtur në jetë?" 13 për qind nga të anketuarit kanë deklaruar se ndjehen shumë të lumtur, 48 për qind ndjehen të lumtur, 30 për qind as të lumtur e as të palumtur, ndërsa gjashtë për qind, d.m.th. një për qind të palumtur dhe shumë të palumtur", thekson Brima Galup.

Në nivel botërore, qytetarët presin vit më të vështirë ekonomik apo, siç qëndron në raport, pesimizmi ekonomik përfundimisht "fitoi". Shpresa, megjithatë, është më e pranishme se pashpresa, por me trend ulje në krahasim me vitin paraprak, ndërsa dy të tretat apo 59 për qind nga të anketuarit në


botë prononcohen si të lumtur. Në rajon, shqiptarët janë më optimist për prosperitetin ekonomik, por kanë edhe më shumë shpresë për vit më të mirë, ndërsa më pesimistë janë grekët. Lidhur me lumturinë, të gjithë janë në a.q drejtim pozitiv. Paraprijnë Kosova me 62 për qind nga të anketuarit, ndërsa e fundit Greqia me 21 për qind. Për hulumtimin e Brima Galup janë intervistuar 53.769 persona në nivel global. Në çdo vend anketimi kombëtar përfshin rreth 1.000 burra dhe gra të cilët janë intervistuar ballë për ballë, përmes telefonave apo online. Puna në terren është zbatuar gjatë nëntor - dhjetorit të vitit 2017. Margjina e përgjithshme e gabimit arrin tre deri pesë për qind. Në Maqedoni është zbatuar anketë në terren, ballë për ballë, në shtëpinë e të anketuarit, në fletëanketa me 1.210 të anketuar më të moshuar se 15 vjet, në periudhë 21 nëntor - 01 dhjetor të vitit 2017, në margjina të gabimit prej +/- tre për qind.

## Nafta nga 1 janari për 3.5 denarë më shtrenjtë

Shkup, 29 dhjetor - Pas rritjes së fundit të çmimit të dizelit gjatë kësaj jave më 25 dhjetor, prej 1 janarit ai do të rritet për 3.5 denarë për shkak të vendosjes së akcizës më të lartë për naftë. Kështu çmimi i ri i Eurodizelit më 1 janar duhet të jetë 58.5 denarë për një litër. Çmim të ri, do të ketë një javë pas festave të fundvitit kur Komisioni Rregulltaor për energjetikë do të sjellë vendim të ri të rregullt për përcaktimin e çmimeve më të larta të derivateve të naftës. "Rekomandimet e BE-së janë se këto akciza duhet të jenë 0,33 eurocent, ndërsa tek ne ishte 0,20 eurocent. Me rritjen do të jetë 0,26 eurocentë", thekson Qeveria gjatë paralajmërimit për rritjen e akcizës së dizelit. Vlerëson se edhe me këtë çmimi i një litri naftë do të mbetet më i ulët në rajon. Shkaku për rritjen e akcizës, siç theksuan nga Qeveria është në pajtim me rekomandimet e Bashkimit Evropian, që të destimulohet përdorimi i karburantëve dizel që të zvogëlohet ndotja e mjedisit jetësor. Të ardhurat të cilat janë planifikuar në Buxhetin për vitin 2018 prej rritjes së akcizës për tre denarë është 1,6 miliardë denarë dhe prej TVSH-së nga shitja e dizelit për rreth 350 milionë denarë. Këto për sivjet janë ndryshimet e vetme tatimore. Në vitin 2019 duhet të pasojnë ndryshimet për tatimim progresiv tek tatimi personal. Paratë prej akcizës duhet të shpenzohen për projekte kapitale në arsim, për kopshtet e fëmijëve, biblioteka, zhvillim rajonal të barabartë, investime kapitale në komuna, shëndetësi dhe sfera të tjera, ndërsa me qëllim që të rritet borxhi publik shtesë.

## Një i vdekur dhe një i lënduar në bulevardin "Serbia"

Shkup, 29 dhjetor - Shoferi i një automjeti taksi vdiq, ndërsa një person është lënduar më rëndë ngjatë një aksidenti rrugor që ndodhi mbrëmë në bulevardin "Serbia" në Shkup. Aksidenti ka ndodhur rreth orës 01:25 kur një automjet i markës "audi A4" i drejtuar nga G.J.D (28) është përplasur me një automjet "pezho 207" i drejtuar nga A.M (60) nga Shkupi, ndërsa pastaj përmes pjesës me bar që ndan korsitë ka kaluar në drejtimin e kundërt dhe është përplasur në gardhin e një pompe benzine dhe automjetin taksi "shkodia oktavia" i drejtuar nga T.J (58) nga Shkupi. Pas aksidentit, audi është përfshirë nga zjarri dhe u dogj tërësisht. Me këtë rast ka intervenuar edhe ekipi nga Brigada Zjarrfikëse Territoriale e Qytetit të Shkupit. Lëndime të lehta trupore, gjegjësisht fraktura në gjunjë kanë marrë B.M (21) nga fshati Sopishte i cili ka qenë bashkudhëtarë u audit.



Shkup, 29 dhjetor - Këshilli Penal për vlerësimin e aktakuzave pranë Gjykatës Penale të Shkupit, të premtën ka njoftuar se janë caktuar datat për fillimin e gjykimeve për rastet "Tank" dhe "Arka". Në fund të muajit të ardhshëm, respektivisht më 30 janar, në GJPSH

## 2018-a NIS ME LËNDËT E PSP-së

pritet të fillojë shqyrtimi i lëndës gjyqësor "Tank", në të cilën Prokuroria Speciale Publike, si të dyshuar kryesor ka ish-funksionarët e lartë të Qeverisë së kaluar. Ish-ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovskaja, ndihmësi i saj Gjoko Popovski dhe ish-kryeministri Nikolla Gruevski pritet të japin përgjigje për keqpërdorim të detyrës zyrtare, gjegjësisht për blerjen e "Mercedesit" të famshëm. Ky vendim i GJPSH-së vjen pasi javë më parë e pranoi akuzën për këtë

lëndë, të cilën PSP e parashtrori në fund të qershorit të këtij viti. Me qëllim parandalimin e prolongimit të seancave gjyqësore, nga GJPSH kanë bërë të ditur se të akuzuarve në këtë rast u janë dërguar ftesat. Akuzat e iniciuar për rastin "Arka", siç kanë njoftuar nga PSP, lidhet me procedurën e furnizimit të pajisjeve për nevojat e Drejtorisë së Pestë (sektor i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim) pranë Ministrinë për Punë të Brendshme. Prokuroria e Katica Janevës, përbajtjen e kë-

saj akuza e ka përmbledhur në 14 faqe, përfshi dëshmitar dhe bisedat telefonike nga "përgjimet e jashtëligjshme". Pjesë e akuzës së këtij rasti është ish-drejtori i DSK-së, Sasho Mijallkov, ish-drejtori i Drejtorisë së Pestë, Goran Grujevski (i cili qëndron në paraburgim në Selanik). Tutje, këtë akuzë e përbëjnë edhe shefi i kabinetit të ish-drejtorit të DSK-së, Toni Jakimovski dhe ndihmësiministri, Nebojshta Stajković. Vepra penale për të cilën akuzohen këta të dyshuar ka të bëjë

me keqpërdorim e mjeteve buxhetore për furnizim të pajisjeve, me qëllim përfitime personale. Sidoqoftë, viti i ardhshëm, krahas këtyre rasteve, në Gjykatën Penale të Shkupit pritet të jetë tejet i ngjeshur me procedimin e lëndëve të parashtruar nga Prokuroria Speciale Publike. Këtë tezë më së miri e vërteton fakti se sistematizimi i fundit në GJPSH ka ndikuar që të gjithë rastet e PSP-së që deri tani kanë filluar të shqyrtohen, do të nisnin nga e para. (O.XH)

2017-A, NJË VIT PËR PLOT TURBULLIRA

# 2018-a, VIT I REFORMAVE DHE I INDRYSHIMIT TË EMRIT



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 29 dhjetor - Viti 2017 për Maqedoninë ishte vit i ngjarjeve të bujshme politike, ku ndërrimi i pushtetit nga VMRO tek LSDM jo vetëm që u zvarrit për katër muaj, por kulmoi edhe me ngjarje të dhunshme ditën 27 prillit, kur dhe u votua që një shqiptar për herë të parë të zgjidhet kryetar i Parlamentit të Maqedonisë - Talat Xhaferi nga BDI. Ishin qindra përkras të VMRO-së që pas zgjedhjes së kryeparlamentarit, hynë me dhunë në Parlament duke sulmuar deputetët e shumicës parlamentare, ndërsa mes atyre më së shumti pësoi kryetari Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, ndërsa dëmtime pati edhe lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, deputetë tjerë dhe disa prej gazetarëve. Sela u tërhoq zvarrë pa ndjenja ndërsa ishte punëtori i sigurimit të Parlamentit, Feta Alimi që e shpëtoi nga hulgjanët maqedonas të mbështetur nga VMRO. Kjo ngjarje mori jehonë gjithandej dhe rriti presionin ndërkombëtar që presidenti Gjorge Ivanov më në fund ta mandatojë liderin e LSDM-së për të formuar Qeverinë - gjë që ndodhi pas një muaji. Qeveria e re me kryeministër Zoran Zaev u zgjodh me 61 vota për - nga 49 deputetë të LSDM-së, 10 të BDI, dhe tre deputetë të koalicionit të atëhershëm LR-PDSH-RDK-UNITETI, ndërsa 5 deputetë e Lëvizjes BESA votuan të përmbajtur. Sa i përket posteve nga partitë shqiptare - BDI fitoi dy zëvendëskryeministër, njëri për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe tjetri për Çështje evropiane, ndërsa nga ministratë fitoi

atë të Drejtësisë, Ekonomisë, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministër pa resor për Investime të huaja në vend. Nga koalicioni i partive shqiptare, Aleanca për Shqiptarët fitoi Ministrinë e Shëndetësisë, RDK Ministrinë e Pushtetit Lokal, ndërsa UNITETI u mjaftua me sekretar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë.

## LUFTA E PA KOMPROMIS PËR GJUHËN SHQIPE

Partitë shqiptare ndonëse në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më pak deputetë - 20 gjithsej, u erdhi shansi historik në sistemin aktual politiko-juridik që vërtetë të kushtëzojnë dy partitë më të mëdha maqedonase - VMRO dhe LSDM për realizimin të kërkesave nacionale, ku më kryesorja ishte avancimi i gjuhës shqipe si gjuhë të dytë zyrtare në vend. Për këtë pati një koordinim paraprak mes partive shqiptare që fituan vende në Parlament - përveç PDSH-së, edhe atë me ndërmjetësimin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama që liderët e BDI-së, ASH-së, PDSH-së, RDK-së, UNITETIT dhe Lëvizjes BESA të nënshkruhet një Deklaratë politike për realizimin e kërkesave në mënyrë graduale të shqiptarëve. Kjo bëri që BDI të përpilojë një draft-ligji për përdorimin e gjuhëve, kur në nënin 1 ishte decizive se përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë tjetër zyrtare është edhe gjuha që e flasin mbi 20 për qind të popullsisë, ndërsa në nenet pasuese - gjuha e dytë zyrtare (gjuha shqipe) të ketë përdorim të gjerë në të gjitha institucionet shtetërore, përfshirë dhe ato

gjyqësore si dhe bankënotat dhe uniformat policore dhe ushtarake. Ndonëse mbi 80 për qind të këtij draft-ligji u pranua nga VMRO dhe lideri i saj i atëhershëm, Nikolla Gruevski, të cilit presidenti Ivanov i dha mandatin më 19 janar të vitit 2017, ndërsa BDI në ditën e fundit të mandatit refuzoi bashkëqeverisje me VMRO-në. Djegia e mandatit për formimin e Qeverisë nuk u prit mirë nga VMRO, e cila shfrytëzoi kryesuesin e seancës nga radhët e saj, Trajko Veljanovski, të bllokoi Parlamentin për një kohë të gjatë përmes fjalimeve, replikave dhe kundër replikave të deputetëve të saj. Ishte Ligji për shqipen që presidenti Ivanov kërkoi garanci nga mandatarin i dytë, Zoran Zaev, që ky Ligj nuk do të prish unitetin e Maqedonisë dhe nuk do të cenojë integritetin e shtetit dhe kushtetutën e vendit. Ndonëse u premtua që Ligji për shqipen do të jetë ndër ligjet e para që do të miratohet në Parlament - menjëherë pas votimit të Qeverisë, kjo nuk ndodhi dhe u zvarrit procesimi i saj në Parlament. LSDM dhe Zaevi arritën të bindin partnerët shqiptarë në Qeveri që Ligji për shqipen të shtyhet për votim pas zgjedhjeve lokale me qëllim që të mos ndikojë në uljen e rejtingut dhe rezultateve zgjedhore tek elektorati maqedonas. Por as pas zgjedhjeve lokale, të cilat Zaev i fitoi mbi 90 për qind te komunat maqedonase - mes tyre dhe një komunë shqiptare - atë të Haraçinës, nuk u shpejtua Ligji për shqipen. Bile, LSDM tentoi që përmes propozimit të 4 amendamenteve të inkorporojë dhe gjuhët e komuniteteve tjera në propozim-ligj. Por kjo u paran-

dalua nga deputetët e BDI-së, duke mos lejuar debat për ato amendamentet bazuar dhe në atë se në ligjet me shenjen e BE-së, debati në komision është i kufizuar në tre ditë. Pas Vitit të RI, më 9 janar kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, premtoi se Ligji për shqipen do të jetë në lexim të dytë ku nuk ka debat dhe do të shkohet direkt në votim. E pritshme është që presidenti Ivanov të mos e nënshkruaj këtë Ligj, i cili dhe mund të kthehet për votim të dytë, por që më pas do të hyjë në fuqi menjëherë pas votimit

## PËRÇARJA, E JO BASHKIMI SIMBOL I PARTIVE SHQIPTARE

Ulja në një tryezën të përbashkët për nënshkrimin e Deklaratës shqiptare e shumicës së liderëve të partive shqiptare dhe disa takime të tyre pas formimit të Qeverisë me fokus përcjelljen e zbatimit të këtij dokumenti u pa me sy të mirë tek opinion shqiptarë, por që në fund rezultoi më çarje të partive të koalicionit qeveritar BDI-ASH, nga e cila çarje përfitoi LSDM duke i marrë atyre Ministrinë e Shëndetësisë edhe atë përmes një kuadri të afërt për shumë vite me VMRO-në. Kur jemi tek interesat shqiptare, partitë nuk mësuan nga pësimi me uljen e numrit të deputetëve nga 27 sa kishin më parë në 20, por në zgjedhje lokale garuan veçmas, ndërsa në rrethin e dytë - ASH bëri koalicion me partinë opozitare BESA, ndërsa BDI dhe LSDM vazhduan koalicionin qendror edhe në nivel lokal, koalicion që i bëri fitues absolut të zgjedhjeve lokale në mbi 90 për qind të komunave.

Ulja në një tryezën të përbashkët për nënshkrimin e Deklaratës shqiptare nga shumica e liderëve të partive shqiptare u pa me sy të mirë tek opinion shqiptarë, por që në fund rezultoi me çarje të partive të koalicionit qeveritar BDI-ASH, nga e cila çarje përfitoi LSDM duke i marrë atyre Ministrinë e Shëndetësisë

## NË PLAN TË DYTË AGJENDAT POLITIKE SHQIPTARE

Fokusi tek reformat në disa sfera - sidomos në gjyqësor, ku dhe rezultoi edhe me nisjen e zbardhjes së rasteve të montuara politike si rasti "Monstra" dhe "Sopot", nga maji kur u formua Qeveria e deri në fund të dhjetorit, nuk u pa diçka serioze që përfituan shqiptarët, veçanërisht nga barazia buxhetore. Kur jemi tek ndarja e pushtetit, LSDM edhe pse pa votat e partive shqiptare asnjë ditë nuk mund të rrijë në pushtet, mori gjithçka deshi nga kulaçi qeveritar, ndërsa shqiptarët u mjaftuan me poste zëvendësish në drejtoritë më të rëndësishme të sigurisë - në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim, Agjencinë për Zbulim, Drejtorinë e Policisë, Drejtorinë e Burgjeve, Drejtorinë për Siguri Publike... Në propozim-buxhetin për vitin 2018 nuk ka planifikim për rritje pagash (veçmas në arsim dhe shëndetësi për 5 për qind). Qeveria për gjatë vitit 2017 ndonëse premtoi zhvillim të barabartë rajonal, 6 muaj që kur formua e njëjta nuk ka një Strategji të qartë si të zhvillojë komunat, ndërsa nuk ka edhe rritje të TVSH për komunat në masën 13 % sa u premtua para zgjedhjeve parlamentare dhe as që është paraparë për vitin 2018 kjo rritje. Investime kapitale as për këtë vit nuk ka për autostradën Shkup-Bllacë dhe ende Qeveria aktuale merret me probleme të planifikimit, ndërsa tani thuhet se autostrada do të nis të ndërtohet tek në vitin 2019. Shqiptarët, mbushës të mëdhenj të buxhetit të shtetit, me gjasë do të presim edhe zgjedhjet lokale të vitit 2021 dhe nuk do të kenë ujë të pijshëm dhe kanalizime nëpër fshatra që kanë dhe mbi pesë mijë banorë. Përdërisa në kohën e qeverisjes së VMRO-së koha kalonte me "Car Dushanin", me "Kalanë", "Kryqin", në kohën e qeverisjes me LSDM si dukjet koha po kalon me "reformat" dhe shqiptarët rrinë anash e vështrojnë se kur do të rea-

lizohen të njëjtat. Assesi të bëhen bashkë pozitë dhe opozitë dhe të determinojë realisht realizimin e kërkesave të shqiptarëve, jo vetëm Ligji për gjuhët, por edhe realizimin në masë 25 për qind të futjes së shqiptarëve në institucionet shtetërore, kur ende kemi institucione që nuk kanë të punësuar asnjë shqiptar, barazinë buxhetore dhe gjëra tjera me interes për shqiptarët.

#### ÇKA PRITET PËR VITIN 2018

Në vitin 2018, siç pritet - Maqedonia mund të merr ftesë për anëtarësim në NATO në Samitin e qershorit, me gjasë me emrin FYROM me që koha e shkurtër prej 5 muajve nuk premtan se do të ketë zgjedhje të çështjes së emrit me Greqinë e që - edhe po të ketë marrëveshje, nuk mund të kalojë pa marrë vullën e Referendumit. Paraprakisht, palët me ndërmjetësimin e SHBA-se dhe të BE-së edhe pse bisedimet zhvillohen nën patronatin e OKB-së, mund të arrijnë marrëveshje për emrin para Samitit të NATO-s, ndërsa emrat që përfliken në kuluaret diplomatike janë "Maqedonia e Veriut", "Maqedonia e re" dhe "Republika e Maqedonisë-Shkupi". Nga kërkesat e shqiptarëve me gjasë do të mjaftohet me miratimin e Ligjit për gjuhët, dhe aspekte tjera të Deklaratës shqiptare zor se mund të realizohen deri në zgjedhjet e ardhshme me siguri të parakohshme bashkë me zgjedhjet presidenciale në prill të vitit 2019-të, kjo pasi zgjedhjet do të imponohen nga realiteti i ri politik me ndryshimin e emrit të shtetit.

Në aspekt të qeverisjes, Aleanca për Shqiptarët mund të zëvendësohet nga PDSH e Menduh Thaçit bazuar edhe në logjikën se kjo parti - në rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale e ndihmoi BDI-në dhe LSDM-në në disa komuna kyçe si në Tetovë, Gostivar, Çair, Strugë e Likovë. Regjistrim të Popullsisë duket që nuk do të kemi dhe për vitin 2018, përmes së cilit shqiptarët shpresojnë shumë se do të rrisin përqindjen në shtet, përqindje kjo që nga regjistrimi i largët i vitit 2012 ishte 25. Ajo që mund të marrë vëmendjen e opinionit vendas dhe ndërkombëtar mund të jenë arrestimet eventual të ish kreut të VMRO-së, ndërsa nuk përjashtohen as ish-zyrtarë të latë qeveritar të BDI-së në rast se Gjykatat vërtetojnë akuzat e Prokurorisë Speciale Publike për korrupsion. Parlamenti në rast të mos hyrjes së PDSH-së në Qeveri dhe që kulaçin qeveritar që kishte ASH të ndajnë mes vete BDI dhe LSDM, do të vazhdojë të jetë me shumicë të brishtë prej 61 deputetësh - LSDM 49, BDI 10, RDK 1 dhe deputeti i pavarur Çedomir Sazdov, por që nuk përjashtohet as bashkëngjitja e deputetit rom Amdi Bajram. Mbetet të shihet nëse ASH dhe BESA do të vazhdojë koalicionin që patën zgjedhje lokale dhe të veprojnë si koalicion karshi pozitës. Në aspektin ekonomik, koha do të kalojë duke stabilizuar Buxhetin dhe nuk premtohet rritje e lartë ekonomike. Si rezultat i presionit të ulët nga partitë shqiptare - edhe viti 2018 mund të kalojë pa u hapur dy pikat kufitare me Kosovën në Bellanoc dhe me Serbinë në Llojan.

## NDARJA E RE TERRITORIALE NEVOJË SHOQËRORE

# SHKUPI I VOGËL I SHQIPTARËVE

**Nevojën për një ridefinim të kufijve të komunave në Shkup, para se gjithash e kërkojnë qytetarët shqiptarë të Shkupit, përfshi edhe ato të rrethinës. Në kohë kur me të madhe flitet se kryeqendra e Maqedonisë paraqet një metropol të vërtetë, mbi 200 mijë shqiptarë (brenda lagjeve e urbane dhe fshatrave përreth) edhe më tej përballen me probleme esenciale siç janë ujësjellësi, kanalizimi dhe infrastruktura e mirëfilltë urbane**



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 29 dhjetor - Shqiptarët e Shkupit vazhdojnë të vuajnë për një ndarje të re territoriale. Mbase kjo problematikë i tangon shumë komuna me shumicë shqiptare, një rishqyrtim i dispozitave të Ligjit për ndarje të territorial, doemos duhet të bëhet kur flitet për zhvillimin dhe integrimin e shqiptarëve që jetojnë në kryeqytet dhe rrethinë. Hartimi i komunave dhe njësive të bashkëqeverisje lokale që u bë në vitin 2004, një pjesë bukur të mirë të vendbanimeve shqiptare i diskriminoi. Megjithatë, izolimi dhe ndarja e shqiptarëve në Shkup, në disa komuna rurale dhe vetëm dy "urbane", rezultoi me një getoizim, i cili dita ditës po rritet. Njohësi i mirë i zhvillimeve nëpër komuna dhe në përgjithësi të decentralizimit si proces, Zahir Bekteshi, për gazetën KOHA thotë se opinioni duhet ta ketë parasysh se ndarja territoriale në radhë të parë është çështje kompromisi, në kohë dhe momente të caktuar. Pastaj, thotë më tej ai, duhet të dihet se ndarja territoriale si kategori i takon ligjeve sistemore, çështje kjo e cila i ka përparësitë dhe mangësitë e veta, përfshi edhe elementet tjera të cilët e determinojnë problematikën e pushteti lokal apo decentralizimit të komunave.

"Për një ndryshim të ndarjes së fudit territorial, e cila u bë në vitin 2004, na duhet një koncept tjetër mental dhe para së gjithash profesional. Sepse, si të tilla që janë ndarë komunat, i kanë mangësitë e deri në mos mundësitë e funksionimit real të komunës. Nuk besoj se tash ekzistojnë kushte elementare për ndryshimin e ndarjes territoriale, megjithatë ajo si problem duhet të trajtohet dhe në moment të caktuar - të vihet aty ku e ka vendin. Në shtet nuk kemi kushte as formale, as praktika që këto 80 komuna, së bashku me Qytetin e Shkupit, në këtë mënyrë ta plotëson idenë e zhvendosjes së pushtetit qendror në atë lokal", thotë Bekteshi. Diskutimet për një ndarje të re territoriale, siç shprehet ai, paraqesin një temë komplekse dhe nuk mund të

flitet vetëm për problemet që ekzistojnë në Shkup, por hapat duhet të bëhen në atë kahe që duhet të respektohen standardet sa i takojnë definimit të komunës si njësi e administrimit lokal. Nevojën për një ridefinim të kufijve të komunave në Shkup, para se gjithash e kërkojnë qytetarët shqiptarë të Shkupit, përfshi edhe ato të rrethinës. Në kohën kur me të madhe flitet se kryeqendra e Maqedonisë paraqet një metropol të vërtetë, mbi 200 mijë shqiptarë (brenda lagjeve urbane dhe fshatrave

përreth) edhe më tej përballen me probleme esenciale siç janë ujësjellësi, kanalizimi dhe infrastruktura e mirëfilltë urbane. Bashkëbiseduesi ynë, Zahir Bekteshi, kur flet rreth kësaj problematikë, vlerëson se duhet të krijohen apo formohen parakushte që kjo çështje, e cila e rëndon edhe shtetin dhe proceset demokratike, në një kohë jo të largët ta ketë trajtimin e duhur. "Nuk duhet të harrojmë se determinimi i Qytetit të Shkupit si njësi e posaçme e administrimit lokal i ka mangësitë e veta, pikërisht për shkak të problemeve aktuale. Në sot nuk kemi decentralizim, por dekoncentrim të pushtetit dhe ajo i bartë problemet. Fatkeqësisht, kjo temë mjaftë pak është trajtuar në mënyrë profesionale, më tepër ka qenë formale, respektivisht Maqedonia si shtet seriozisht vazhdon të ballafaqohet me problemin e decentralizimit", nënvizon Bekteshi.



**Çairi është komuna më e vogël e Maqedonisë për nga sipërfaqja duke mbuluar vetëm 3.52 kilometra katrorë me më shumë se 65 mijë banorë**

Në sot nuk kemi decentralizim, por dekoncentrim të pushtetit dhe ajo i bartë problemet. Fatkeqësisht, kjo temë mjaftë pak është trajtuar në mënyrë profesionale, më tepër ka qenë formale, respektivisht Maqedonia si shtet seriozisht vazhdon të ballafaqohet me problemin e decentralizimit", nënvizon Bekteshi.

Profesori universitar, njëherësh edhe ish-ministër i Vetëqeverisjes Lokale (2002-2006), Rizvan Sulejmani, thekson se popullata shqiptarë vërtet paraqet kategorinë e cila

#### RIZVAN SULEJMANI

**Fatkeqësisht, në mesin e shumë njësive të decentralizimit, pjesa urbane e Shkupit, me theks të posaçëm Komuna e Çairit, ka një dendësi të madhe të popullatës, me çka presioni mbi këtë komunë rritet edhe më tepër me procesin e urbanizimit dhe modernizimit të shoqërisë shqiptare. Gjithsesi, kur i kemi parasysh këto rrethana, nevoja për gjetjen e një zgjidhje doemos duhet të kërkohet me shikimin e mundësisë për zgjerim.**

shpreh më tepër pakënaqësi sa i përket procesit të decentralizimit dhe kompetencave të cilat pushteti qendror ia ka deleguar pushtetit lokal. Ai, kur flet për procesin e decentralizimit, thotë se ka ardhur koha që të ndërmerret diçka sa i përket organizimit territorial të Maqedonisë. "Kur flasim për komunat shqiptar, mendoj se ato kërkojnë një vëmendje të posaçme, qoftë nga aspekti i menaxhimit, si për mënyrën e funksionimit, apo kualitetin e shërbimeve që ua ofrojnë qytetarëve. Komunat shqiptare dhe shoqëria jonë përgjithësi ballafaqohet me një proces tejet di-

namik, siç është rasti i urbanizimit dhe modernizimit të shqiptarëve, i cili detyrimisht me arsimimin dhe integrimin e gruas shqiptare në institucione (arsimimin dhe punësimi i saj) është imponuar si çështje e një migrimi fshat-qytet. Kështu krijohen edhe problemet shtesë, gjatë këtyre proceseve të mëdha", thotë profesori Sulejmani.

Fatkeqësisht, sipas tij, në mesin e shumë njësive të decentralizimit, pjesa urbane e Shkupit, me theks të posaçëm Komuna e Çairit, ka një dendësi të madhe të popullatës, me çka presioni mbi këtë komunë rritet edhe më tepër me procesin e urbanizimit dhe modernizimit të shoqërisë shqiptare. Gjithsesi, profesori thekson se kur i kemi parasysh këto rrethana, nevoja për gjetjen e një zgjidhje doemos duhet të kërkohet me shikimin e mundësisë për zgjerim. Mirëpo, siç dihet, ndryshimi i kufijve të komunave miratohet me dy të tretat e votave (81 deputetë). Ekspertët e decentralizimit thonë se zakonisht kur hapen këto tema të ndeshme, nënkuptohet se politikisht shumë vështirë mund të menaxhohen. Megjithatë, ata shprehen se nëse krijohet një ambient politikisht më i qetë, atëherë janë të mendimit se kjo çështje do të diskutohej më lehtë, gjegjësisht ky problem esencial me siguri se mund të zgjidhej.

PA EKSTERNEN, KEMBRIXHIN DHE SHQIPTARËT

# VITI I PLOGËSHTISË SHQIPTARE NË ARSIM

Nuk është rastësi që tërheqja e librave skandaloze nisi nga "bishti" dhe jo nga "koka", pra nga libra që i bëjnë të ndehen keq të divorcuarit, ata që bashkëjetojnë ose janë pjesë e komuniteteve LGBT. Për librat që ofendojnë dhe nxisin urrejtje ndaj shqiptarëve, asnjë problem. Fundja, nuk kishte se kush t'ia kërkon ministres Deskovska largimin e atyre librave. Shqiptarët në 2017-ën ishin të vetë përjashtuar nga të gjitha proces për reformimin e arsimit, ishin jashtë çdo vendimarrje. Kjo aventurë dhe plogështi politike, s'ka dyshim që do të ketë edhe koston e vet

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 29 dhjetor - Si rrallë ndonjë vit tjetër nga pavarësimi i Maqedonisë, 2017-a u kaloi shqiptarëve pa ndikim politik në institucionin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Me gjysmë viti ministër në largim, siç ishte rasti i Pishtar Lutfiut dhe gjysma tjetër pa ose me zëvendësministra që assesi të ushtrojnë si duhet postin e tyre, nga '91-shi e kënde, shqiptarët zor se mund të kenë një vit tjetër si ky që shkoi, me zero influencë në krijimin e politikave arsimore. Deri në ardhjen e ministres aktuale Renata Deskovska, paraardhësi i tij Pishtar Lutfiu edhe po të kishte në dorë - nuk mund të ushtonte asnjë pushtet ministri për shkak të gjashtë muajve vakum që krijoi periudha e stërzgatur e rotacionit të pushtetit.

Lutfiu ishte thjeshtë një ministër formal, i cili mezi priste të bëjë dorëzimin e postit edhe ashtu të sikletshëm. MASH-i është njëri prej dikastereve më të rënda sa i përket llojllojshmërisë së problemeve reale e që për më tepër se kaq - prekin grupe të gjëra njerëzish, pikëpamjesh, përkatësi etnike, sociale, gjinore dhe fetare. Të jesh në krye të atij institucioni dhe të mos mund ta drejtosh atë - është njësoj si të luftosh me mullinj të erës. Por, fatkeqësisht aventura shqiptare e politikave të arsimit në 2017 nuk përfundoi me kaq.

## "OUT" NË MOMENTE VENDIMTARE

Shqiptarët nuk arritën të bëhen pjesë e MASH-it as nga pozicioni i zëvendësministrit të Arsimit. Në fund të dhjetorit, nga partia në pushtet - BDI, u kumtua emri i Arbër Ademiti si zëvendësministër i Arsimit, ndërsa paraardhësi i tij Visar Ganiu nuk i bëri as tre javë të plota në këtë post. Tamam sa duhej të fillonte punën si zëvendësministër, Ganiu e caktuan kandidat për kryetar të Komunes së Çairit, ku edhe është aktualisht. E paralelisht plogështisë për pushtet në nivele të larta, brenda institucionit të MASH-it veç më ishte rrënuar fuqia e ndikimit të kuadrove shqiptare në nivele sektorësh apo njësi drejtuese. Fatkeqësisht, gjithë kjo apati vjen në një kohë kur MASH-i edhe zyrtarisht kishte shpallur fillimin e proceseve të "reformave të madha", kur nisi të sillen vendime të rëndësishëm si ai për ndërprerjen e vlerësimit ekstern të



nxënësve, kur ndërpritet kontrata për botimin e teksteve shkollore nga një qendër e posaçme e Universitetit të Kembrixhit, kur përgatitet Propozim-ligj për arsimin e lartë, kur përpilohet Strategjia Gjithëpërfshirëse Arsimore (2018-2025), kur përgatitet Buxheti zhvillimor për arsimin dhe shkencën, kur tërhiqen nga përdorimi tekstet shkollore, kur paralajmërohen ndryshime të shumta, kur gjërat filluan të lëvizin në një drejtim të ri... E, mbi të gjitha - kur shkollimi në gjuhën shqipe ka një mijënjë probleme të tjera.

Në këtë situatë të zhvillimeve që në mënyrë të drejtpërdrejtë tangojnë arsimin, shqiptarët mbetën krejtësisht jashtë proceseve të vendimarrjes dhe krijimit të politikave se nga do të orientohen lëvizjet e MASH-it të paktën në katër vitet e ardhshme (aq sa presupozohet se mund të zgjat një mandat qeverisje). Nuk është rastësi që tërheqja e librave skandaloze nisi nga "bishti" dhe jo nga "koka". Duke pasur në qarkullim dhjetëra tekste shkollore nga lënda e Historisë, Gjeografisë, Muzikës apo Artit, që me përmbajtjen e tyre stimulojnë gjuhën e urrejtjes etnike dhe nxisin qasjet separate ndaj shqiptarëve dhe komuniteteve tjera jo maqedonase, ministrja Deskovska zgjodhi të merr vendim për largimin e librit të lëndës së Kulturës Qytetare, pasi përmbajtja e mësimave për familjen qenka shumë konzervatore. Pra, me motivacionin se libri nuk është gjithëpërfshirës, re-

spektivisht se nga koncepti për familjen përjashtohen kategoria e të divorcuarve, bashkëjetesës apo martesave të së njëjtës gjini, ministrja e Arsimit solli vendim për largimin nga përdorimi të atij libri. Fyerjet dhe ofendimet e panumërta që u bëhen shqiptarëve në tekste të tjera shkollore nuk janë me rëndësi. Në 2017, Deskovska nuk pati kurajën të veprojë me këto libra njësoj siç bëri me librin e lëndës së Kulturës Qytetare. Fundja, askush nuk ia kërkoi një gjë të këtillë. Shqiptarët kishin mbetur thjeshtë "jetimë" në institucionin e MASH-it. Edhe kur ishin fizikisht, nuk ishin prezent me fuqinë e pushtetit dhe seriozitetin që duhej ti karakterizonte nga niveli politik. Shqiptarët në 2017 ishin të vetëpërjashtuar nga të gjitha proces për reformimin e arsimit, ishin jashtë çdo vendimarrje. Kjo aventurë dhe plogështi politike, s'ka dyshim që do të ketë edhe koston e vet.

## NGA PLENUMI NË MINISTRI

Ndryshimet në arsimin e lartë do të jenë kryefjala e politikave arsimore në vitin 2018. Siç ishte premtuar që para ardhjes në pushtet të LSDM-së, partisë së kryeministrit Zoran Zaev, një prej veprimeve të para do të ishte ndryshimi i Ligjit për arsim të lartë. Kështu edhe ndodhi. Në fillim të dhjetorit, MASH bëri publike Propozim-ligjin përkatës të firmosur nga Renata Deskovska, një ish-plenumiste tanimë ministre e Arsimit dhe Shkencës, Kthimi i autonomisë uni-

versitare dhe i lirisë akademike, apo çlirimi i universiteteve nga kthetrat e qeverisë, në të vërtetë ishte "Kali i betejës" në luftën politike për ardhjen në pushtet të LSDM-së. Që me konstituimin e Qeverisë në prill të 2017-ës, ishte e qartë se MASH-i do ti takonte kësaj partie dhe jorastësisht në krye të këtij dikasteri u emërua një profesoreshë e Universitetit "Kirili dhe Metodi" të Shkupit. Për më tepër se kaq, Deskovska kishte qenë pjesë e Plenumit të Profesorëve, atij Plenumi që në periudhën e viteve 2014-2015, në bashkëveprim me Plenumin e Studentëve, i dhanë Qeverisë së kaluar goditjen më të rëndë akademike. Përmes organizimit të protestave dhe lëvizjeve tjera masive, ata shënjestruan fytyrën diktatoriale të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski dhe me këtë - i trasuan rrugën e sigurt. Sidoqoftë, sa të kujtohen shqiptarët të marrin në dorë pushtetin e caktuar paraprakisht me qeverisjen LSDM-BDI (nga pozita e zëvendësministrit), gjërat kanë rrjedhur ashtu siç janë nis pa pjesëmarrjen e tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Në vend që të bëheshin edhe ata krijues të politikave arsimore, strategjive dhe ligjeve, do të duhet të merren me korrigjimin e gjërave që mund të mos u pëlqejnë. Do të merren me pasojat dhe jo shkakun, si gjithmonë.

Problemet me shkollimin në gjuhën shqipe, pa përjashtuar edhe arsimin e nivelit të lartë janë të shumta. Kështu, për shembull, në Buxhetin e MASH-it për vitin

2018 mungojnë milionat e premtuara për ndërtimin e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, apo nuk janë në atë sasi siç ishte premtuar se do të ndahen për këtë vit. Ishte deklaruar disa herë se për ndërtimin e kampusit universitar të UNT-së në Shkup - gjatë tre viteve të ardhshme do të ndahen rreth 21 milionë euro apo për afërsisht nga 7 milionë secilin vit. Mirëpo, për UNT-në me Buxhetin e 2018-ës parashihet të ndahen në total rreth 4.700.000 euro, duke përfshirë në këtë zë të gjitha shpenzimet e nevojshme, si rroga dhe kontributet e të punësuarve, mirëmbajtje, blerje të pajisjeve dhe mobileve të nevojshme apo edhe për shpenzimeve të tjera. Pra, nga ai buxhet duhet të ndahen edhe mjete për ndërtimin e kapustit universitar e për të cilin nuk do të ketë 7 milionë euro sikurse ishte premtuar, por vetëm 3 milionë e 240 mijë euro, ose 200 milionë denarë.

Nga ana tjetër buxhete të veçanta në vlerën e 3 milionë e 240 mijë eurove (200 milionë denarë) janë ndarë për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e objekteve për UKM-së, konkretisht për objektet e Fakultetit të Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike si dhe për Fakultetin e Kulturës Fizike. Këta mjete, pra i janë ndarë UKM-së, përveç 22 milionë eurove të tjera që janë planifikuar ti shkojnë universitetit për shpenzime të tjera të nevojshme. Të llogaritura në total, UKM merr pjesë me mbi 25 milionë euro në buxhetin e përgjithshëm të arsimit të lartë, që për vitin 2018 do të jetë rreth 340 milionë euro.

UKM vazhdon të mbajë tiparin e institucionit të arsimit të lartë me buxhetin më të madh në Maqedoni, duke lënë shumë prapa universitetet tjera publike, si ai i Tetovës, Manastirit, Shtipit dhe Ohër. Në bazë të planifikimeve nga buxheti bazë, për Universitetin e Tetovës do të ndahen 5 milionë e 372 mijë euro dhe që është dukshëm më pak se buxheti i njëjtë i një viti më parë. Me buxhetin e 2017-ës, për këtë universitet (më të madhin në gjuhën shqipe) ishin planifikuar mbi 6 milionë euro. Edhe në 2018-ën, pjesa dërmuese e financimit nga shteti shkojnë për rroga dhe kontribute. Për shpenzimet tjera, universiteteve u duhet të "prodhojnë" të hyra nga buxhetet vetanake, donacionet apo nga inkuadrimi nëpër projekte.

DEBATI VAZHDON NË 2018



# NJË LIGJ NDRYSHE

## PËR ÇMIMET SHTETËRORE

Por pavarësisht se si njëri çmim, ashtu edhe tjetri nuk arritën të ndaheshin për shkak të skadimit të mandateve të anëtarëve të këshillave përkatës për ndarjen e çmimeve dhe bllokimit të punës në Komisionin parlamentar për zgjedhje dhe emërim, gjatë 2018 lista e çmimeve shtetërore nuk do të jetë e njëjtë. Ndryshimi i kësaj liste, pesë prej të cilave jepen nga Ministria e Kulturës dhe dy të tjerat nga Ministria e Arsimit dhe Agjencia e Rinisë dhe Sportit është i pritshëm. Mënyrimi nga kjo listë, si për shembull për çmimin 23 Tetori, që konsiderohet si partiak, por edhe vendosja e çmimeve të tjera, apo edhe rikategorizimi i tyre është i pashmangshëm

Koha

Evis HALILI

Shkup, 29 dhjetor - Çmimi shtetëror për kontribut në fushën e publicistikës dhe gazetarisë ishte i dyti me radhë që nuk u nda gjatë vitit 2017, ashtu si edhe çmimi "23 Tetori", Dita e Luftës revolucionare maqedonase. Por pavarësisht se si njëri çmim, ashtu edhe tjetri nuk arritën të ndaheshin për shkak të skadimit të mandateve të anëtarëve të këshillave përkatës për ndarjen e çmimeve dhe bllokimit të punës në Komisionin parlamentar për zgjedhje dhe emërim, gjatë 2018 lista e çmimeve shtetërore nuk do të jetë e njëjtë. Ndryshimi i kësaj liste, pesë prej të cilave jepen nga Ministria e Kulturës dhe dy të tjerat nga Ministria e Arsimit dhe Agjencia e Rinisë dhe Sportit është i pritshëm. Mënyrimi nga kjo listë, si për shembull për çmimin 23 Tetori, që konsiderohet si partiak, por edhe vendosja e çmimeve të tjera, apo edhe rikategorizimi i tyre është i pashmangshëm. Ajo që nuk dihet është nëse kjo listë do të ndryshojë profilin monoetnik që e ruan prej dekadash.

### NJË VIT PA DY ÇMIME

Çmimi shtetëror "Mito Haxhi Vasiliev" do të duhej të ndahej më 21 dhjetor, në Parlament, por shkak se konkursi për këtë çmim nuk arriti të shpallej nga 1 deri më 31 tetor, procedura dështoi. Në sqarimin që jepet nga ana e Ministrisë së Kulturës thuhet se Komisioni parlamentar për zgjedhje dhe

emërim nuk arriti të realizonte procedurat dhe të emëronte anëtarët e këshillit, mandati i të cilëve skadoi në muajin qershor. Ministria e Kulturës kërkon që kjo procedurë të përfundojë në mënyrë që dhënia e këtij çmimi të mos vihet në pikëpyetje për vitin e ardhshëm. I njëjti arsyetim jepet edhe për çmimin 23 Tetori, çmim ky që ndahet për arritje në sferën e shkencës, kulturës, arsimit, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe promovimit të prioritetëve shtetërore, vlerave dhe trashëgimisë kulturore-historike të Maqedonisë. Në Ministrinë e Kulturës pohojnë se mosndarja e çmimeve u bë për shkak të moskryerjes së procedurës në Kuvend, në komisionin përkatës. Por nuk e përzjashtojnë mundësinë për ndryshimin e përmbajtjes së çmimeve që jepen. Në grupet e punës të ngritura nga Ministria e Kulturës është debatuar për korrektimet që duhet të pësojnë ato dhe për vetë Ligjin për çmimet shtetërore.

"Vitin e ardhshëm do të hapet debat publik për legjislaturën në kulturë, sigurisht se pjesë e këtij debati mund të jete edhe lista e çmimeve shtetërore, por nuk do të kisha prejjudikuar lidhur me rezultatet e debatit ose vlerësimet e ekspertëve dhe komunitetit kulturor në vend për këtë çështje", thotë këshilltari i posaçëm i ministrit, Petrit Saraçini.

Ndryshimet janë kërkuar vazhdimisht nga pjesa shqiptare e komunitetit artistik në Ligjin për çmimet shtetërore. Fituesit e këtyre

çmimeve kanë kërkuar që të ndryshojë jo vetëm përbërja, por edhe rëndësia e secilit çmimit dhe rrjedhimisht edhe benefitet që përfiton marrësi i tyre. Por ndryshimet ligjore të pesë viteve më parë kanë qenë të fundit.

Sipas shpërblimit që shoqëron çmimin dhe të ardhurat në formë pensioni që fituesi i merr gjatë të gjithë jetës çmimi më i rëndësishëm mbetet "11 Tetori" – Dita e kryengritjes së popullit maqedonas (është ndarë në vitin 1959 për herë të parë). Jep mirënjohjen më të lartë për veprën jetësore në fushën e shkencës, artit, ekonomisë si dhe në veprimtari të tjera me interes publik. Sipas ligjit, brenda një viti mund të ndahen deri në pesë çmime dhe shoqërohet me një shpërblim që kap një vlerë prej 15 pagash mujore mesatare.

Çmimi i dytë, i miratuar në vitin 1969 është "Shën Klimenti i Ohrit" dhe "Goce Dellçev" (Ministria e Arsimit). Sa i takon rëndësisë, por edhe motivacionit "Shën Klimenti i Ohrit" është po aq potent sa edhe "11 Tetori". Të njëjtën "peshë" ka edhe 23 Tetori, një prej çmimeve më të reja. Është ndarë për herë të parë në vitin 2007 dhe akordohet për arritje në sferën e shkencës, kulturës, arsimit, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe promovimit të prioritetëve shtetërore, vlerave dhe trashëgimisë kulturore-historike të Maqedonisë.

### MË MIRË SHËN KLIMENTIN SE SHËN TEREZËN

Një prej figurave më emble-

matike të Maqedonisë është humanistja Nënë Terezë. Por emri i saj paradoksalisht qëndron në listën e çmimeve shtetërore e kategorizuar shumë poshtë. Për përfituesit e çmimeve më të pakënaqurit kanë qenë ato të cilëve i është akorduar, jo për motivacionin, por për benefitet. Çmimi është pjesë e listës prej vitit 2006 dhe jepet në ditën e lindjes së shenjtore, më 26 gusht. Me motivacionin për arritje në fushën e humanitetit, solidaritetit njerëzor dhe për nxitjen dhe avancimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes bashkësive, kulturave dhe religjioneve. Vlera është pesë paga mujore mesatare, duke e klasifikuar në të njëjtën kategori së bashku me "Goce Dellçev" (Ministria e Arsimit) dhe "Mito Haxhi Vasiliev Jasmin". Dhe për këto çmime shtetërore edhe është gara është e vogël, po ashtu si edhe interesimi për të marrë pjesë në konkurs dhe për të kandiduar individë nga sfera të ndryshme. Kështu kanë deklaruar nga sektori për dhënie e çmimeve gjatë viteve të kaluara. Problemet me dhënie e çmimeve nuk qëndrojnë vetëm tek përbërja e listës, emrat dhe datat që përmban ajo. Një tjetër mangësi janë edhe përzgjedhjet që bëhen nga Parlamenti lidhur me emërimet e anëtarëve të këshillave për ndarjen e çmimeve, që zakonisht kanë një mandat dy vjeçar. Në shumë raste përbërjeve të tyre u ka munguar si përfaqësimi i duhur etnik, por edhe profesional për të bërë vlerësimet.

**"11 TETORI" (MINISTRIA E KULTURËS).** Dita e kryengritjes së popullit maqedonas. Jep mirënjohjen më të lartë për veprën jetësore në fushën e shkencës, artit, ekonomisë, si dhe në veprimtari të tjera me interes publik. Brenda një viti mund të ndahen deri në pesë çmime. Vlera: 15 paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 1959.

**"SHËN KLIMENTI I OHRIT" (MINISTRIA E KULTURËS).** Dita e Shën Klimentit, 8 dhjetor. Jep mirënjohjen më të lartë për arritje shumëvjeçare në fushën e edukimit, arsimit, kulturës, artit, shëndetit, sportit, mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit human dhe në veprimtarinë sociale. Brenda një viti jepen deri në pesë çmime. Vlera: 10 paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 1969.

**23 TETORI (MINISTRIA E KULTURËS).** Dita e Luftës revolucionare maqedonase (i shtuar në vitin 2007). Jep mirënjohje më të lartë për arritje në sferën e shkencës, kulturës, arsimit, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe promovimit të prioritetëve shtetërore, vlerave dhe trashëgimisë kulturore-historike të Maqedonisë. Brenda një viti jepen më së shumti pesë çmime. Vlera: 10 paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 2007.

**"GOCE DELLÇEV" (MINISTRIA E ARSIMIT).** Dita e vdekjes së Goce Dellçev, 4 maj. Jep mirënjohje për arritje në sferën e shkencës. Brenda një viti jepen më së shumti deri në tre çmime. Vlera: pesë paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 1969.

**"MITO HAXHI VASILIEV JASMIN" (MINISTRIA E KULTURËS).** Dita e lindjes së Mito Haxhi Vasilievit, 21 dhjetor. Jep mirënjohje për arritje në sferën e publicistikës dhe gazetarisë. Brenda një viti mund të akordohen deri në dy çmime. Vlera: pesë paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 1969.

**"NËNË TEREZA" (MINISTRIA E KULTURËS).** Dita e lindjes së Nënë Terezës, 26 gusht. Jep mirënjohje për arritje në fushën e humanitetit, solidaritetit njerëzor dhe për nxitjen dhe avancimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes popujve, si edhe mes përfaqësuesve të bashkësive, kulturave dhe religjioneve të ndryshme. Brenda një viti jepet deri në dy herë. Vlera: pesë paga mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 2006.

**8 SHTATORI (AGJENCIA E TË RINJVE DHE SPORTIT) (2012).** Dita e pavarësisë së Maqedonisë. Jep mirënjohje për arritje në sferën e sportit për sportistë, trajnerë dhe punonjës në sport. Brenda një viti mund të akordohen deri në pesë çmime. Vlera: dhjetë paga mujore mesatare. Pension i përjetshëm në vlerën e një page mujore mesatare. Është akorduar për herë të parë në vitin 2012.

BIZNESET PRIVATE NË MAQEDONI TË PAKËNAQUR ME BUXHETIN 2018

# MË SHUMË PARA PËR KAFE SESA PËR BIZNESE

Shuma prej 617 mijë euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - në aspekt të analizës së numrave realisht nuk paraqet asgjë, sepse për 71.286 kompani sa janë të regjistruara, i bie që çdo kompani të sigurojë mbështetje shtetërore në vlerë prej 8.65 euro, shumë kjo më shumë se poshtëruese



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 29 dhjetor - Mjetet financiare në vlerë prej 30 milionë të para para për mbështetjen e kompanive dhe bizneseve private, vlerësohen vetëm si kujdes i shprehur nga shteti, mirëpo shuma e paraparë si ndihmë assesi nuk është e mjaftueshme për mbështetje të sinqertë të sektorit privat. Për analistin ekonomik Arben Halili, nëse krahasojmë numrin e kompanive të vogla dhe të mesme të regjistruara në Maqedoni me shumën prej 617 mijë eurove që parashihet me Buxhetin e vitit 2018, kjo vlerë realisht nuk paraqet asgjë, sepse siç thotë Halili, për 71.286 kompani i bie që secila të marrë 8.65 euro, gjë që është shumë poshtëruese.

"Nga të dhënat e Entit Statistikor të Maqedonisë, numri i përgjithshëm i subjekteve aktive në Maqedoni është 70.193 kompani, që në bazë të një matematike të thjeshtë - del që si proporcion, shpërndarja do të jetë nga 8.65 euro për ndërmarrje, gjë që është shumë poshtëruese. Megjithatë, po ashtu diskutabile do jetë edhe forma e shpërndarjes së kësaj vlere. Cilat janë kriteret në bazë të cilave do bëhet shpërndarja dhe në emër të çka? Do të ishte pa diskutim shumë e rëndësishme që faktori konkurrencë dhe kompanitë, të cilat janë në fazën mbijetesës dhe rritjes në treg, të jenë ata që do kishin përparësi të mbështetjes financiare nga ana e shtetit. Pikërisht këta kompani kanë nevojë për mbështetje", thotë Halili. Ai njëherësh potencon se ndodh që për arsye të publikut, prezantohen si shuma kumulative, por jo edhe efekti real që pritet të arrihet për kompanitë.

"Unë nuk besoj që ekziston kompani në vend që me mbështetje prej 8.65 euro ose 10.87 euro, do mund të përmirësojë kushtet e punës ose produktivitetin e saj. Nga 71.519 kompani të regjistruara në

Maqedoni, madje 71.286 janë kompani të vogla dhe të mesme, respektivisht kompani që kanë deri në 250 punëtorë. Vlera prej 617.000 euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në aspekt të analizës së numrave realisht nuk paraqet asgjë, sepse për 71.286 kompani i bie që çdo kompani do sigurojë mbështetje nga ana e shtetit në vlerë prej 8.65 euro. Por edhe sikur kjo vlerë të dedikohet vetëm për kompanitë që kanë nga 1-9 të punësuar e që janë 56.725 kompani, shuma për kompani është 10.87 euro", thotë Halili. Në fakt, numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë të vendosura në Zonat industriale në vend, zona këto që janë krijuar nga ana e bizneseve private me zero mbështetje nga ana e shtetit, siç është ajo e Vizbegut.

"Aty realizojnë aktivitetin e vet biznesore një numër i konsiderueshëm i kompanive dhe të njëjtat në vazhdimësi - edhe pse kanë kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga ana e shtetit, prapë se prapë në mënyrë private kanë siguruar edhe infrastrukturën elementare në këtë zonë. Pikërisht

efekti që gjenerojnë kompanitë në Zonën e Vizbegut është shumë më i madh në aspekt të punësimit të njerëzve, si edhe prodhimtarisë dhe vëllimit të shërbimeve që ofrojnë këta kompani, krahasuar me vlerën buxhetore për mbështetje të kompanive të vogla dhe të mesme nga ana e shtetit. Vlera prej 617 mijë euro nuk është e mjaftueshme - e në raste të caktuara, edhe vetëm për një kompani jo më për të gjitha kompanitë e vogla. Vlerësoj se më korrekte do të ishte të mos prezantohej një shifër e tillë nënvlerësuese për kompanitë. Ekzistojnë me qindra kompani në vend që vetëm qarkullimin javor e kanë disa qindra milionë euro, kështu që nevoja konkrete e kompanive është sigurimi i mbështetjes për tregje të reja dhe të sigurta, siguri ligjore dhe mbi të gjitha - në aspekt të

edukimit për implementim të drejtë të ligjeve", thotë Arben Halili, analist ekonomik. Edhe Fatmir Bytyqi, ekspert ekonomik, njëherësh biznesmen, thotë se me vlerën e paraparë për mbështetje për sektorin privat të biznesit, Qeveria e re nuk tregon dëshirë serioze të mbështet financiarisht sektorin privat.

"Të them të drejtën, pritjet e mia ishin më ndryshe, por në Buxhetin e vitit 2018 nuk i shoh. Nuk mund të pajtohem se intervenimi shtetëror për mbështetje të bizneseve mund të bëhet me 30 milionë euro - aq më shumë ku nga këto 30 milionë euro, 16.6 milionë euro shkojnë për kompanitë vendore, ndërsa pjesa tjetër prej 13.4 milionë euro shkon për investitorët e huaj", thotë Bytyqi. Me vetë faktin se vitin e ardhshëm, sipas Qeverisë, kemi realisht buxhet më të lartë në histori prej 3.5 miliard euro, Bytyqi thotë se vetëm 30 milionë euro apo 16.5 milionë euro të shkojnë si mbështetje për kompanitë vendore është një vlerë tepër nënçmuese.

"Nga 3.5 miliard euro të ndahen vetëm 30 milionë euro për mbështetje të ekonomisë është qesharake siç është qesharake edhe rritja e akcizës së naftës dhe përfitimet nga kjo rritje do të jenë 30 milionë euro", thotë Bytyqi. Kjo mbështetje e shtetit, Bytyqi thotë se nuk është mbështetje serioze që do të sjell efekte pozitive për biznesin privat në afat të mesëm dhe afatgjatë. "Nëse shikoni Zonën industriale në Vizbeg, kapitali i kompanive në këtë zonë është 670 milionë euro edhe në nivel vjetor realizojnë qarkullim prej mbi 600 milionë euro, ndërsa mbështetja e shtetit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është 617 mijë euro. Për çfarë mbështetje prej 617 mijë euro flasim", thotë Bytyqi. Vitin e kaluar, thotë ai, qarkullimi vjetor i vetëm kompanive që funksionojnë në këtë zonë në kushte të vështira pa asfarë infrastrukturë rrugore, pa ujësjellës, kanalizim dhe rrjetë të mirëfilltë energjetike



FATMIR BYTYQI

**Nëse shikoni Zonën industriale në Vizbeg, kapitali i kompanive në këtë zonë është 670 milionë euro edhe në nivel vjetor realizojnë qarkullim prej mbi 600 milionë euro, ndërsa mbështetja e shtetit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është 617 mijë euro. Për çfarë mbështetje prej 617 mijë euro flasim**



ARBEN HALILI

**Vlera prej 617.000 euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në aspekt të analizës së numrave realisht nuk paraqet asgjë, sepse për 71.286 kompani i bie që çdo kompani do sigurojë mbështetje nga ana e shtetit në vlerë prej 8,65 euro. Por edhe sikur kjo vlerë të dedikohet vetëm për kompanitë që kanë nga 1-9 të punësuar e që janë 56.725 kompani, shuma për kompani është 10.87 euro**

, vetëm një firmë vitin e kaluar në këtë zonë ka sjellë 5 milionë euro në ekonomi, ndërsa shteti vlerëson se 617 mijë euro mbështetje është e mjaftueshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. "Sigurisht se diku ka gabim me perceptimin dhe pritjet. Kam pritjet që kjo mbështetje të jetë 617 milionë euro apo 61 milionë euro dhe atëherë mund të flasim për përkrahje reale nga shteti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", shprehet Bytyqi.

Edhe për analistin ekonomik, Sinisha Pekeski, është absurde të flasësh për ndihmë shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kur gjatë vitit 2016 dhe 2017, shumë pronarë të bizneseve uavunë drynin bizneseve të tyre. "Përkrahja shtetërore prej 600 mijë euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është e barabartë me 18 vetura në vlerë prej 35.000 euro që drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe ministrat kanë paralajmëruar se do t'i blejnë gjatë vitit 2018. Në vend që shteti të investojë më shumë para në përkrahje të atyre që krijojnë vlera, gjithmonë këta subjekte i vendos në vendin e fundit në listën e shtetit si prioritet", thotë Pekeski. Nëse do të shihni se sa para harxhohen për reprezentime, nëpër kafene, apo udhëtime zyrtare, atëherë bëhet e qartë se sa edhe ky buxhet është zhvillimor dhe nuk jep asnjë përkrahje për ato të cilët me të vërtetë kanë nevojë. "Mbesim me shpresë se viti 2018 do të jetë një vit i ringjalljes ekonomike në Maqedoni, sepse është treni i fundit para se të shpërthejë një pakënaqësi totale e qytetarëve, dhe kam frikë se gjërat do të përkeqësohen shumë dhe do të vijë deri të trazirat e mëdha sociale. Në njërin anë ka politikanë milionerë, e nga ana tjetër njerëz që janë ka vuajnë për kafshatën e bukës. Ka ardhur koha që me i thënë mjaft kësaj situatë", thotë Sinisha Pekeski analist ekonomik.



PUBLIKOHET BAROMETRI BALLKANIK

# KORRUPSIONI NUK SHKULET DOT

Në Barometrën e vitit 2015, 15 për qind e të anketuarve kanë vlerësuar se korrupsioni paraqet një nga problemet kryesore në rajon, ndërsa një vit më vonë - kjo shifër është rritur në 27 për qind. Sivjet (2017), 32 për qind e të anketuarve kanë theksuar korrupsionin si problemin më të madh



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 29 dhjetor - Shumica e qytetarëve të Evropës Juglindore nuk janë të kënaqur me situatën në shoqëri, ndërsa ndër problemet kryesore, krahas papunësisë - e theksojnë korrupsionin. Se ky problem është ndër brengat kryesore të qytetarëve në Ballkan e konfirmojnë edhe raportet dhe analizat e ndryshme të institucioneve relevante ndërkombëtare. Bile në vitet e fundit rritet shqetësimi i tyre edhe për mitmarjen, tregon Barometri Ballkanik i vitit 2017 që analizon opinionin e qytetarëve për situatën në rajon.

"Është brengosëse se sipas rezultateve të Barometrit, sa vjen e më shumë rritet frika nga korrupsioni. Në Barometrën e vitit 2015, 15 për qind e të anketuarve ka vlerësuar se korrupsioni paraqet një nga problemet kryesore në rajon, ndërsa një vit më vonë, kjo shifër është rritur në 27 për qind. Sivjet, apo në vitin 2017, 32 për qind e të anketuarve kanë theksuar korrupsionin si problemin më të madh", thotë Goran Svilanović, sekretari i Këshillit për bashkëpunim rajonal që përgatit Barometrën Ballkanik të bazuar në anketën ndër qytetarët e Ballkanit.

Raporti më tej thekson se më shumë se gjysma, apo 58 për qind e qytetarëve nuk janë të kënaqur me situatën në shoqëri, ndërsa të kënaqur janë shprehur vetëm 14 për qind e të anketuarve në hulumtimin e realizuar në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi. Anketa më tej tregon se pas papunësisë me 67 për qind dhe situatën ekonomike me 46 për qind, në vend të tretë lidhur me problemet që shqetësojnë qytetarët në Ballkan me 32 për qind është korrupsioni.

"Anketa ka treguar se në Kosovë,

korrupsioni paraqet problemin e dytë më të madh në shtet me të cilin ballafaqohet qytetarët pas ekonomisë, që paraqet brengë të madhe për 62 për qind të të anketuarve, apo dyfish më shumë se në shtetet e tjera të rajonit. Nga ana tjetër, 66 për qind e të anketuarve në Maqedoni kanë thënë se nuk ju besojnë gjykatave dhe gjyqësorit. Gjithashtu, në Maqedoni, 38 për qind e të anketuarve e që paraqet përqindjen më të lartë në rajon, kanë deklaruar se Qeveria e tyre lufton korrupsionin në mënyrë efikase", tregon Barometri Ballkanik.

Nga vërejtjet kryesore të raportit vlen të theksohet se në Shqipëri, 54 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë paguar për shërbime publike dhe shëndetësore, që si përqindje është më e larta në rajon. Në Serbi, 80 për qind e të anketuarve thonë se dogana është më shumë e përfshirë nga korrupsioni. Në Bosnje e Hercegovinë, 82 për qind e të anketuarve nuk i besojnë Qeverisë, ndërsa 80 për qind vlerësojnë se mediat janë të prekura nga korrupsioni. Në Mal të Zi, me 70 për qind të anketuarit vlerësojnë se partitë politike janë të prekura nga korrupsioni, ndërsa 63 për qind e tyre vlerësojnë se zyrtarët apo shërbimet publike gjithashtu janë të prekura nga korrupsioni.

Në ndërkohë, kryetari i Iniciativës rajonale për luftimin e korrupsionit, Davor Dubravica, thotë se luftimi i kësaj dukurie negative kërkon vullnet politik dhe media të pavarura. Sipas tij, zgjerimi i korrupsionit është një nga shkaqet kryesore të mosbesimit të lartë të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. Është interesant të theksohen edhe pritjet e qytetarëve të rajonit lidhur me implementimin e ligjeve dhe efikasitetin e procedurave administrative.

Anketa tregon se 82 për qind e qytetarëve të anketuar të Ballkanit Perëndimor, vlerësojnë se më të korruptuarat janë partitë politike, të pasuara me 80 për qind të gjyqësorit, me nga 79 për qind të doganave dhe institucioneve shëndetësore. Gjithashtu, 47 për qind e të anketuarve besojnë se autoritetet religjioze janë të korruptuara, ndërsa 55 për qind mendojnë se organizatat joqeveritare janë të prekura nga korrupsioni. Nga ana tjetër, pjesa dërmuese e popullatës,

apo 73 për qind nuk ndjejnë se Qeveritë e tyre luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive.

Në ndërkohë, sfidat e rajonit për të luftuar më tej ndjesinë e korrupsionit që shpesh edhe nuk mund të matet dhe vlerësohet, por vetëm të ndjehet, e kanë theksuar edhe autoritetet amerikane. Sipas senatorit amerikan Kris Marfi, në Ballkan



**66 për qind e të anketuarve në Maqedoni kanë thënë se nuk ju besojnë gjykatave dhe gjyqësorit. Gjithashtu, në Maqedoni, 38 për qind e të anketuarve e që paraqet përqindjen më të lartë në rajon, kanë deklaruar se Qeveria e tyre lufton korrupsionin në mënyrë efikase**

është arritur përparim i madh, por megjithatë akoma ka sfida si korrupsioni, andaj Bashkimi Evropian paraqet rrugë të qëndrueshme ndaj të ardhmes. "Në Ballkan është arritur përparim i madh dhe ky tregim duhet të vazhdohet, por megjithatë akoma ekzistojnë sfida. Kjo është lufta kundër korrupsionit në rajon, dhe për shkak të kësaj - duhet të bëjmë qartë se BE, edhe më tej është rruga e qëndrueshme ndaj ardhmërisë, për shkak se integrimi është një nga gjërat që nxit reformat kur bëhet fjalë për korrupsionin", thotë Marfi. Edhe nga progres

raportet e shteteve të Ballkanit Perëndimor të publikuara nga ana e Komisionit Evropian vitet e fundit mund të kuptohet se pamjaftueshmëria në luftën kundër korrupsionit është problemi i përbashkët i vendeve të rajonit që ngadalëson edhe anëtarësimin e këtyre shteteve në BE. Nga ana tjetër, raporti i Transparency International (TI) i publikuar në 2017-ën, në fund të nëntorit për korrupsionin në nivel global gjatë vitit 2015, pasqyron gjendjen e përgjithshme jo të lakmueshme në rajon lidhur me luftimin e korrupsionit. Vendet e Ballkanit Perëndimor, synimi kryesor i të cilave është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, sipas këtij raporti, bëjnë pjesë në dy të tretat e vendeve më të korruptuara të botës. Kjo tregon një pasivitet në luftën kundër korrupsionit duke qenë se asnjëra nga këto nuk është duke e dhënë maksimumin për të arritur objektivin e anëtarësimin në BE. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, TI i ka renditur në mesin e shteteve me prezencë të lartë të korrupsionit. Asnjëri nga këto vende nuk ia doli të futet madje as në listën e 50 shteteve me më së paku korrupsion. Transparency International për të parë perceptimin për korrupsion dhe shkallën në të cilën është i shtrirë ai në një shoqëri apo shtet, mbledh të dhënat e analistëve dhe të ekspertëve në shtetet e ndryshme për rryshfetin nga ana e zyrtarëve publik, rryshfetin në prokurimin publik dhe përvetësimin e kundërligjshëm të fondeve publike. Analistët ekonomik ndërkohë vlerësojnë se shkak kryesor i nivelit më të lartë të korrupsionit në shtetet e Evropës Juglindore në raport me shtetet e vjetra anëtare të BE-së është moszbatimi në praktikë i ligjeve të ndryshme anti-korrupsion.

## ÇFARË ËSHTË BAROMETRI BALLKANIK

**I porosur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RÇÇ) që nga viti 2014, Barometri Ballkanik është pjesë e kornizës së monitorimit për strategjinë e Evropës Juglindore 2020 (EJL 2020), një agjendë rajonale e miratuar në vitin 2013 nga Maqedonia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Strategjia synon të rrit prosperitetin dhe krijimin e vendeve të**

**punës në rajon, si dhe të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe evropian. Ai paraqet hulumtimin vjetor për mendimet dhe pritjet e qytetarëve dhe afaristëve për tema të ndryshme si punësimi, korrupsioni, investimet etj. Në edicionin e tretë kanë qenë të përfshirë 8000 qytetarë dhe 1600 biznese të anketuara.**

# 2017-A, VITI I DHUNËS NË MAQEDONI

Në vitin 2017, Maqedonia hyri me një krizë politike, e cila me mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016, pritej të për-

fundojë. Pas zgjedhjeve, partitë politike negociuan me qëllim formimin e Qeverisë, ndërsa për shkak të kësaj krize që vazhdoi edhe gjatë muajve të parë të këtij

viti, institucionet shtetërore nuk ishin plotësisht funksionale, gjë që e vështirësoi më shumë funksionimin normal të qytetarëve të këtij vendi. Fillimi i vitit 2017 po ash-

tu ishte edhe skenë e protestave të iniciativës qytetare "Për Maqedoni të përbashkët", të cilët për më shumë se një muaj protestuan kundër të ashtuquajturës "Platfor-

ma e Tiranës", për të përfunduar me hyrjen dhunshëm në Parlament dhe rrahjen e deputetëve, ku më së keqi pësoi Ziadin Sela, atëkohë i LR-PDSH-së.



27 PRILL. Pas zgjedhjes së Talat Xhaferit kryetar të Parlamentit të Maqedonisë, protestuesit e iniciativës qytetare "Për Maqedoni të përbashkët", të cilët u tubuan jashtë shtëpisë ligjvënëse, u futën me forcë brenda institucionit. Si rezultat i protestuesve të dhunshëm që synonin deputetët, u plagosën rreth 100 persona, duke përfshirë deputetë, pjesëtarë të forcave policore dhe përfaqësues të mediave.




4 MAJ. Pas një periudhe disa mujore negociatash, që vijuan pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit 2016, u formua shumicë parlamentare.



17 MAJ. Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, i dorëzoi mandatin Zoran Zaevit për të formuar Qeverinë e re në Maqedoni.



8 KORRIK. Stadiumi kombëtar "Filipi i dytë" në Shkup priti finalen e UEFA Superkupës mes skuadrave Real Madrid dhe Manchester United. Në këtë ndeshje morën pjesë mijëra tifozë nga vende të ndryshme evropiane.



29 TETOR. Raundi i dytë i zgjedhjeve lokale në Maqedoni. Në Gostivar fiton Arben Taravari i Aleancës për Shqiptarët. Në nivel shteti, LSDM fitoi 57 komuna, BDI 10, VMRO 5, ASH 3, dhe Lëvizja BESA 1, aq sa edhe PDSH. VMRO përfundoi me 5 komuna.



2 NËNTOR. Njoftohet dënimi i 37 të akuzuarve nga grupi i armatosur për ngjarjet e 15 majit të vitit 2015 në "Lagjen e Trimave" të Kumanovës, në të cilin shtatë persona u dënuan me burgim të përjetshëm, katër u liruan dhe të pandehurit e tjerë morën dënim me burg prej 12 deri në 40 vjet.



23 NËNTOR. Qeveritë e Maqedonisë dhe Bullgarisë zhvilluan një seancë të përbashkët mes dy qeverive në Strumicë të Maqedonisë, pas së cilës ministrat e institucioneve të të dy vendeve nënshkruan marrëveshje dhe memorandume në disa fusha me rëndësi të përbashkët, ndër të cilat marrëveshje për intensifikimin e punëve të jashtme, trajnimin e vozitësve në fushën e mbrojtjes, bashkëpunimin në raste të katastrofave, marrëveshje për heqjen e roaming-ut, si dhe të tjera në fushën e investimeve, energjetikës, mbrojtjes dhe turizmit.



5 DHJETOR. Gjykata Penale shqiptoi paraburgim 30-ditor për deputetët Krsto Mukoski, Ljuben Arnaudov dhe Sasho Vasilevski, ndërsa për deputetët Johan Tarçulovski, Zhaklina Peshevska dhe Ljupço Dimovski shqiptoi arrest shtëpiak. Deputetët akuzohen si pjesëmarrës në ngjarjet e 27 prillit në Kuvendin e Maqedonisë, ku 36 persona janë në ndjekje penale.



10 DHJETOR. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, dha dorëheqjen e tij nga udhëheqja e partisë. Në krye të partisë, Gruevski është që nga viti 2003.



1 DHJETOR. Gjykata Supreme në Maqedoni ka liruar nga paraburgimi katër të dënuarit në rastin "Monstra", duke ua zëvendësuar atyre masën me arrest shtëpiak. Agim Ismailović, Fejzi Aziri, Sami Luta dhe Haki Aziri janë katër të liruarit, të cilët do të mbrohen në liri derisa zhvillohet rigjykimi. Rasti "Monstra", për vrasjen e pesë të rinjve maqedonas tek Liqeni i Smilkovës në vitin 2012, u kthye në rigjykim pas kërkesës së prokurores Liljana Spasovska.



23 NËNTOR. Qeveritë e Maqedonisë dhe Bullgarisë zhvilluan një seancë të përbashkët mes dy qeverive në Strumicë të Maqedonisë, pas së cilës ministrat e institucioneve të të dy vendeve nënshkruan marrëveshje dhe memorandume në disa fusha me rëndësi të përbashkët, ndër të cilat marrëveshje për intensifikimin e punëve të jashtme, trajnimin e vozitësve në fushën e mbrojtjes, bashkëpunimin në raste të katastrofave, marrëveshje për heqjen e roaming-ut, si dhe të tjera në fushën e investimeve, energjetikës, mbrojtjes dhe turizmit.



## Republika e Maqedonisë Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore

Në bazë të nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/15 – tekst i pastruar dhe 27/16) dhe nenit 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16) Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore, me seli në rr. "Dame Grucev" nr. 14, në Shkup publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorëve për kohë të caktuar deri më 30.06.2018 në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore për vendet e punës në vijim

**1. Inkasant për pagesa rrugore,** në Departamentin për pagesa rrugore dhe kontroll, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **74 (shtatëdhjetekatër) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Përgatitje të mesme profesionale – së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvojë pune – me ose pa përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me dy ndërrime dhe zgjatë 12 orë

- Orari ditor i punës prej ora 07,00 deri në ora 19,00 dhe prej ora 19,00 deri në ora 07,00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 19.760,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**2. Mirëmbajtës të higjienës së objekteve** në Departamentin për pagesa rrugore dhe kontroll, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **1 (një) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Arsimit fillor – së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune

- Orari ditor i punës prej ora 07.00 deri në ora 15.00

- Orari i punës është i rregulluar me një ndërrim dhe zgjatë 8 orë në ditë

- Puna gjatë ditëve të punës – prej ditës së hënë deri ditën e premte

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 16.848,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**3. Rojtar,** në Departamentin për menaxhim me resurset njerëzore dhe punë të përgjithshme, në Sektorin për punë juridike, resurse njerëzore dhe punë të përgjithshme – **1 (një) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Arsimit fillor – së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune

- Orari i punës është i rregulluar me një ndërrim dhe zgjatë 8 orë në ditë

- Orari ditor i punës prej ora 08,00/8.30 deri në ora 16,00/16.30

- Puna gjatë ditëve të punës – prej ditës së hënë deri ditën e premte

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 16.848,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**4. Udhëheqës së departamentit për kontroll të komunikacionit,** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **1 (një) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit nga sfera e makinerisë, komunikacionit dhe transportit ose elektroteknikë

- Përvojë e punës – së paku dy vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat

- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, për çka të dorëzohet vërtetim,

- Njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), për çka të paraqesin certifikatë e njohur ndërkombëtarisht të dhëna nga testator zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian, ose certifikatë nga institucion ndërkombëtar për AI nivelin e CEFR, gjegjësisht BULATS ose TOEFEL PBT së paku 310 pikë, TOEFEL CBT së paku 35 pikë ose TOEFEL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë

- Orari i punës është i rregulluar me një ndërrim dhe zgjatë 8 orë në ditë

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari ditor i punës prej ora 08,00/8.30 deri në ora 16,00/16.30

- Puna gjatë ditëve të punës – prej ditës së hënë deri ditën e premte

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 35.776,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**6. Referent për kontroll të komunikacionit** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **4 (katër) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.00 deri në ora 22.00 dhe ndërrimi i tretë prej ora 22.00 deri në ora 06.00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 20.800,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.



Република Македонија  
Јавно претпријатие за  
државни патништа

ЕМБС: 6839673

ул.Даме Груев бр.14

1000 Скопје,

Република Македонија

Тел: (02) 3-228-454

(02) 3-118-044

Факс: (02) 3-220-535

Бр. \_\_\_\_\_

Дата: \_\_\_\_\_

Скопје

**6. Referent për kontroll të komunikacionit** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **4 (katër) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.00 deri në ora 22.00 dhe ndërrimi i tretë prej ora 22.00 deri në ora 06.00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 20.800,00 denarë

Krahas kushteve të posaçme të lartpërmendura, të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore nr. 02-11513/1 të datës 29.11.2017, kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme për punësim të punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**7. Referent teknik** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **8 (tetë) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.00 deri në ora 22.00 dhe ndërrimi i tretë prej ora 22.00 deri në ora 06.00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 19.760,00 denarë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**8. Referent teknik** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **8 (tetë) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.00 deri në ora 22.00 dhe ndërrimi i tretë prej ora 22.00 deri në ora 06.00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 19.760,00 denarë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**9. Referent teknik** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **8 (tetë) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.00 deri në ora 22.00 dhe ndërrimi i tretë prej ora 22.00 deri në ora 06.00

- Punë gjatë festave dhe punë gjatë natës

- Vendi i realizimit të detyrave të punës është në Punktin e kontrollit në Negotinë

- Orari javor i punës është 40 orë

- Pagesa bazë është 19.760,00 denarë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit,

- Vërtetim/dëshmi për përvojën e punës

- Certifikatë të shtetësisë.

**Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter.**

**Punësimi do të jetë për kohë të caktuar deri më 30.06.2018.**

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

**10. Referent teknik** në Departamentin për kontroll të komunikacionit, në Sektorin për mirëmbajtje, mbrojtje të rrugëve dhe pagesë rrugore – **8 (tetë) realizues,** me plotësimin e kushteve të posaçme në vijim:

- Së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm katërvjeçar

- Përvoja e punës – së paku një vjet përvojë pune në profesion

- Orari i punës është i rregulluar me tre ndërrime dhe zgjatë nga 8 orë edhe atë ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00, ndërrimi i dytë prej ora 14.



## Universiteti i Tetovës Универзитет во Тетово University of Tetova

Republika e Maqedonisë, 1200 Tetovë - Тетово, Рр.-Ул. Илинденит - Илинденска, Rektorati i Universitetit - Ректорат на Универзитетот  
Republic of Macedonia, www.unite.edu.mk Tel: +389 44 356 500 Fax: 334 - 222

Në pajtim me rregullat e programit Erasmus + dhe Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë në kuadër të Komisionit Evropian, Universiteti i Tetovës, në kuadër të projektit  
*THE MAIN ELEMENT OF US*  
SHPALL KONKURS ME NUMËR 001/2017

për sigurimin e operatorit ekonomik për realizimin e projektit Erasmus + të UE-së. Operatori ekonomik duhet të sigurojë:

1. Udhëtim për 10 persona në relacionin Tetovë – Madrid, Spanjë dhe anasjelltas për pjesëmarrje në mbledhje në kuadër të projektit Erasmus +.
2. Udhëtim për 5 persona në relacionin Tetovë – Sofje, Bullgari dhe anasjelltas për pjesëmarrje në mbledhje në kuadër të projektit Erasmus +.
3. Udhëtim për 2 persona në relacionin Tetovë – Sofje, Bullgari dhe anasjelltas për pjesëmarrje në mbledhje në kuadër të projektit Erasmus +.
4. Akomodim dhe ushqim për në Sofje, Bullgari (shpenzimet individuale – akomodimin, ushqimin dhe pijet, ndihmën materiale, ndihmën mjekësore, sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e shëndetit në udhëtim) për 2 persona gjatë 2 ditëve (duke i përfshirë edhe ditët e udhëtimit).
5. Udhëtim për 2 persona në relacionin Tetovë – Madrid, Spanjë dhe anasjelltas për pjesëmarrje në mbledhje në kuadër të projektit Erasmus +.
6. Akomodim dhe ushqim për në Madrid, Spanjë (shpenzimet individuale – akomodimin, ushqimin dhe pijet, ndihmën materiale, ndihmën mjekësore, sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e shëndetit në udhëtim) për 2 persona gjatë 2 ditëve (duke i përfshirë edhe ditët e udhëtimit).
7. Udhëtim për 2 persona në relacionin Tetovë – Stamboll, Turqi dhe anasjelltas për pjesëmarrje në mbledhje në kuadër të projektit Erasmus +.
8. Akomodim dhe ushqim për në Sofje, Bullgari (shpenzimet individuale – akomodimin, ushqimin dhe pijet, ndihmën materiale, ndihmën mjekësore, sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e shëndetit në udhëtim) për 2 persona gjatë 2 ditëve (duke i përfshirë edhe ditët e udhëtimit).
9. Dokumentacion për implementimin e aktiviteteve:
  - Përgatitja e kontratave për mësim (Learning Agreements) në pajtim me rregullat e programit Erasmus + të Komisionit Evropian;
  - Përgatitja e kontratave për kontrollin dhe sigurimin e kualitetit të praktikës (Quality commitment Agreements) në pajtim me rregullat e programit Erasmus + të Komisionit Evropian;
  - Përgatitja e çertifikatave *Europass* në pajtim me instruksionet e Drejtorisë së Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë në Komisionin Evropian;
10. Raport narrativ në mjetin për mobilitet (Mobility Tool) për aktivitetet e realizuara të grantit të programit E+ të Komisionit Evropian;

11. Raport financiar në mjetin për mobilitet (Mobility Tool) për aktivitetet e realizuara të grantit të programit E+ të Komisionit Evropian;
12. Ngjarje për shumëfishimin e rezultateve të projekteve dhe qasje në projekt në pajtim me rregullat e aksionit përkatës;

Vërejtje të detyrueshme:

1. Operatori ekonomik të posedojë ose të ketë bashkëpunim të drejtpërdrejtë me ndonjë subjekt juridik, i cili posedon licencë A, të dhënë nga Ministria e Ekonomisë.
2. Operatori ekonomik ta pranojë mënyrën e pagesës: 80% përgjatë implementimit të aktiviteteve dhe 20% pas miratimit të raportit final deri në fund të vitit 2019.
3. Operatori ekonomik të ketë përvojë në realizimin e së paku 5 projekteve Erasmus + nga fusha e arsimit dhe trajnimit në 2 vitet e fundit nga shfrytëzues nga Republika e Maqedonisë. Të njëjtat vërtetohen vetëm me letër për vërtetim nga bartësi i grantit gjegjësisht numri referues evropian.
4. Operatori ekonomik të sigurojë memorandum për bashkëpunim me këto institucione:

*Institute for development of training and mobility*  
Sofia, Bulgaria  
office@idtm.bg

*ADEFIS JUVENTUD INTERNACIONAL*  
Madrid, Spain  
cvazquezconde@hotmail.com

*HACETTEPE UNIVERSITESI BEYTEPE KAMPUSU REKTORLUK*  
BINASI  
Cankaya Ankara  
jusuf85@hacettepe.edu.tr

Universiteti i Tetovës,  
Tetovë, Maqedoni  
Personi për kontakt: Prof. Dr. Arbër Çeliku

Konkursi zgjat 10 (dhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij.

Të gjitha ofertat duhet të dërgohen në: Universiteti i Tetovës, rr. Ilindenit pn , 1200 Tetovë, R. e Maqedonisë

### KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMIT “GOCE DELLÇEV”

shpall

#### KONKURS

#### PËR NDARJEN E ÇMIMIT “GOCE DELLÇEV” NË VITIN 2018

Me çmimin “Goce Dellçev” ndahen mirënjohje shoqërore për arritjet veçanërisht të rëndësishme në të gjitha lëmit shkencore në interes të Republikës së Maqedonisë.

Çmimi në vitin 2018 ndahet për libër ose vepër shkencore të publikuar në vitin 2017.

Çmimi sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për çmimet shtetërore (“Gazeta zyrtare në Republikën e Maqedonisë” nr. 52/2006, 54/07 и 74/12) dhe me këtë konkurs ndahet për individ ose grup autorësh nga vendi ose jashtë vendit.

Të drejtë konkurrimi kanë veprat e një autori ose veprat e një grup autorësh që janë publikuar veçmas të recensuara dhe kataloguara. Për datën e publikimit llogaritet data që është e shpallur në katalogimin e publikimit (CIP). Të drejtë konkurrimi nuk kanë të arriturat të publikuara në revista profesionale dhe shkencore me impakt faktor, si dhe kapituj dhe pjesë të librave.

Individ ose grup autorësh mund të jenë fitues i çmimit në lëmin e njëjtë vetëm një herë.

Anëtar nga grupi i autorëve mund si individ të jetë fitues në çmimin për libër ose vepër tjetër në lëmin e njëjtë.

Propozime për ndarjen e çmimeve mund të parashtrihen: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, universitetet, institucionet shkencore, njësit hulumtuuese zhvillimore në ekonomi, shoqata shkencore dhe profesionale dhe shoqata tjera qytetare dhe qytetarë.

Propozimi për ndarjen e çmimeve duhet të arsyetohet dhe të përmbajë: të dhënat personale për autorët, adresa e vendbanimit, të dhëna bibliografike dhe arsyetim të shkurtër për rëndësinë e realizimit i cili propozohet për çmim. Propozimet për vepër ose libër shkencor të publikuara në gjuhë të tjera duhet të përmbajnë **rezime të shkurtër në gjuhën maqedonase deri në 3 faqe dhe përmbajtje në gjuhën maqedonase deri në 3 faqe.**

Propozimet për ndarjen e çmimeve duhet t'i bashkëngjiten 22 ekzemplarë. Me propozimin gjithashtu duhet të bashkëngjiten së paku **3 shembuj origjinal** nga libri shkencor përkatësisht vepra, ndërsa 10 të tjerat kopje.

Propozimet për ndarjen e çmimeve duhet të dorëzohen prej **01.01. 2018 deri 15. 02. 2018** në adresën:

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**Këshilli për ndarjen e çmimeve “Goce Dellçev”**

**1000 Shkup, “Kirili dhe Metodi” nr. 54**

Propozimet e pakompletuara dhe propozimet të cilët nuk janë dorëzuar në afatin e caktuar nuk do të shqyrtohen:

**KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMEVE “GOCE DELLÇEV”**

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 187/2015, 94/16 dhe 158/16) dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup nr. 0204-3308 të datës 10.11.2017 publikon:

#### THIRRJE PUBLIKE

**Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit**

Shoqëria aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i Lumit Vardar aksi Stobi, rajoni i rrjedhjes së Vardarit në pajtim me Pëlqimin e Ekonomisë së Ujërave për rregullim të shtratit të lumit të Lumit Vardar, aksi Stobi nr. 11-1266/2 të datës 14.11.2012 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepriç shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 150,00 denarë plus 7 % kompensim për ujërat plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 127.779 m3.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit.  
Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë **“OFERTË – MOS HAP”**, për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 150.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup.

Hapjen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik, emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 03.01.2018 në ora 12.00 në lokalit të SHA Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup nr. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë.

Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza:

Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankand

Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve

Faza e tretë – ankand publik

Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të shtratit të lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e Ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-515 – Andrea Najdenovski.



# *gëzuar festat*



**ALKALOID**  
SKOPJE

*Shëndeti para së gjithash*

[www.alkaloid.com.mk](http://www.alkaloid.com.mk)

## ADOLESHENTËT E NGUJUAR NGA GJAKMARRJA



## TË BRAKTISUR NGA SHTETI

Programi "Arsimi në vatër" po pushon së ekzistuari një dekadë pasi u mundësoi dhjetra fëmijëve të ngjuar në qarkun e Shkodrës që të merrnin mësimet bazë, ndërsa mësuesit vullnetarë shprehin shqetësimin për lënien jashtë sistemit arsimor dhe jashtë vëmendjes të adoleshentëve të prekur nga gjakmarrja

Anila DUSHI

I rritur në ngujim në rrethinat e Shkodrës, Marjani - sot 22 vjeç, mundet të lëvizë lirisht falë pajtimit të pjesshëm mes familjeve në hasmëri. Ndërsa po përpiqet të largohet përfundimisht nga vendi, Marjani i tha BIRN-it se ai mundet sot të ndjekë një jetë normale vetëm falë dy mësuesve të tij, të cilët i vajtën në shtëpi gjatë viteve të ngujimit dhe i dhanë mësimet bazë atij, vëllait dhe motrës. "Qëndroja në shtëpi bashkë me motrën dhe vëllanë tjetër. Na ka ardhur për të na dhënë mësim në shtëpi mësues Leka dhe mësues Kujtimi. U jam mirënjohës se falë tyre kam shkollën bazë", tha Marjani për BIRN.

"Pastaj u largova nga Shqipëria, por kur vij i takoj mësuesit që nuk më lanë analfabet dhe ruaj respekt për ta", shton ai. Dy mësuesit e Marjanit, Lekë Pjetri dhe Kujtim Troshani ishin pjesë e një grupi më të gjerë arsimtarësh në fshatrat e Shkodrës dhe malësinë përreth, të cilët prej vitit 2006 nxitën qeverinë që të fillonte projektin e "Arsimit në vatra" për fëmijët e ngjuar nga gjakmarrja.

Bashkë me mësuesit Luljana Luani dhe Enkelejda Mataj ata kishin filluar më herët të jepnin mësim vullnetarisht në shtëpitë e këtyre fëmijëve, por vetëm në vitin 2016, qeveria vendosi zyrtarisht të ndërhynte.

Por një dekadë më pas, programi pushoi së ekzistuari pasi sipas Drejtorisë së Arsimit në Shkodër, në zonën e mbuluar nga projekti nuk ka më fëmijë të moshës së arsimi të detyrueshëm të ngjuar. Zyra e statistikave e DAR - Shkodër i tha BIRN se numri kishte rënë nga 46 në vitin 2011 në 5 vitin 2016. Për vitin 2017, sipas Drejtorisë Arsimore, numri i fëmijëve të ngjuar është zero. Drejtorja e Shërbimeve Sociale në bashkinë e Shkodrës e cila furnizon me të dhëna Drejtorinë Arsimore i tha BIRN se ka

informacion për 20 familje të ngjuara me 10 të mitur, por ata nuk kualifikohen në moshën e arsimit të detyruar. Mbyllja e programit me argumentin se nuk ka më fëmijë të arsimit të detyrueshëm të ngjuar kundërshohet nga mësuesit vullnetarë. Në intervista të veçanta për BIRN, ata thonë se ka ende fëmijë të ngjuar në zonat e thella të cilët nuk janë përfshirë në program, por problem kryesor sipas tyre mbeten të miturit që e kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm.

Liljana Luani thotë se ajo vazhdon të shkojë në fshatrat e thella të Veriut, ku ka ende sipas saj të paktën 30 fëmijë të ngjuar që ajo i viziton dhe u jep mësim. Mësuesja thotë se këta fëmijë nuk ishin të përfshirë në projektin e qeverisë, i cili përgjatë një dekade ndihmoi disa dhjetëra nxënës kryesisht në fshatrat rreth Shkodrës dhe lagjet e qytetit, por nuk preku zonat e thella dhe fshatrat jashtë këtij



**Ata më me fat kanë ikur nga Shqipëria apo janë zhvendosur në zona të tjera të vendit larg Shkodrës që nuk dihen dhe as identifikohen. Por, pjesa tjetër mbeten të ngjuar dhe me pak mundësi për një jetë normale**

qarku. Ndërsa mësuesi Lekë Pjetri nga fshati Bardhaj i tha BIRN se shkollimi që u ishte ofruar fëmijëve të ngjuar nuk është i mjaftueshëm, duke i lënë ata jashtë niveleve të tjera të shkollimit.

"Ajo që është bërë për këtë kategori duke i dhënë mësim në shtëpi padyshim është shumë pozitive, por jo e mjaftueshme. Ndonëse nxënësit e ngjuar kanë marrë dëftesën e arsimit bazë dhe njohurit të mjaftueshme për lëndët kryesore, mundësitë që ata të vazhdojnë nivelet e tjera të shkollimit nuk janë,

ndërsa projekti i qeverisë nuk përfshin ndihmë të mëtejshme," pohon Pjetri.

Mësuesi shpjegon se moshja e adoleshencës, pas të cilës këta fëmijë nuk marrin më mësim, konsiderohet nga gjaksi si alternativë hakmarrjeje, ndërkohë që mundësitë ekonomike dhe kushtet e familjeve të tyre "nuk e lejojnë vazhdimin e shkollës edhe sikur të jenë të pajtuar apo në besë".

"Ka prej tyre që më shkruajnë letra, tregojnë se punojnë për të mbajtur familjet. Kushtet ekonomike janë tepër të rënda, po ashtu dhe problemet sociale që mbart fenomenin," thotë Pjetri.

Statistikat sa i përket numrit të familjeve apo të fëmijëve të ngjuar në Shqipëri janë shpesh spekulative. Numrat zyrtarë janë kryesisht minimalë, ndërsa organizatat që thonë se merren me pajtimin e gjaqeve japin shifra disa herë më të mëdha, por këto të fundit janë vënë disa herë në akuzë për shkak të spekulimit me certifikatat që përdoren në vende të Perëndimit për të kërkuar azil. Të dhënat e Drejtorisë Arsimore të Shkodrës tregojnë se në vitet 2008-2011 nga programi "Arsim në vatra" morën mësim 171 fëmijë. Por pas tejkalimit të moshës së arsimit të detyrueshëm bazë, këta fëmijë mbeten jashtë sistemit arsimor dhe pa asnjë ndihmë për zhvillim të mëtejshëm. Mësuesi Lekë Pjetri thotë se për shumicën e adoleshentëve me të cilët ai mban kontakte, jeta vijon të jetë e ashpër. Sipas Pjetrit, ata më me fat kanë ikur nga Shqipëria apo janë zhvendosur në zona të tjera të vendit larg Shkodrës që nuk dihen dhe as identifikohen. Por, pjesa tjetër mbeten

të ngjuar dhe me pak mundësi për një jetë normale.

"Pasi kryejnë arsimin e detyruar, ata konsiderohen të rritur dhe angazhohen në kërkimin e rrugëve për mbijetesë", thotë ai. Mësuesi tregon se në disa raste ata shkojnë në zonat e thella nga kanë ardhur dhe merren me punë sezonale bujqësie në pronat e mëparshme të familjes. "Nuk kam dijeni që të ketë të ngjuar ose ish- të ngjuar nga ata që u kemi dhënë mësim në shtëpi që të kenë vazhduar shkollën më tej," thotë ai.

Pjetri kujton megjithatë se shumë gjëra kanë ndryshuar prej kohës kur ai filloi të jepte mësim vullnetarisht në një familje me tre fëmijë, të cilët u ngjuan vetëm pak muaj para se të mund të mbyllin arsimin e detyrueshëm dhe të jepnin provimet e lirim. Edhe mësuesit e tjerë kujtojnë se situatat në të cilat janë përfshirë nuk kanë qenë më komodet. Atyre u duhej të ndiqnin Kanunin, të kërkonin besë te familja armike dhe të fitonin besimin e familjes ku jepnin mësim. Shpesh situatat kanë qenë absurde. Enkelejda Mataj tregon se para disa vitesh ka dhënë mësim në një familje me fëmijë të ngjuar në lagjen "Skenderbeg" të qytetit, në periferi.

Ajo tregon se ishin dy fëmijë, motër e vëlla që nuk shkonin në shkollë nga frika e gjakmarrjes pasi babai i tyre kishte vrarë baxhanakun e tij, pra burrin e tezes. Ai kishte ikur jashtë vendit, ndërsa nëna me dy fëmijët ishte zhvendosur në Shkodër ku jetonte në një shtëpi të vjetër dy katëshe me qera. Bashkë me të ishte zhvendosur edhe motra e saj, bashkëshortja e të vrarit.

"Ato jetonin në të njëjtën banesë, secila në një kat edhe pse sipas Kanunit ishin në gjak. Fëmijët komunikonin me njëri-tjetrin, por në shkollë shkonin vetëm fëmijët e të vrarit, pasi ata të vrasësit nuk kishin leje nga fisi i viktimës dhe pse jetonin në një shtëpi dy palët", përfundon mësuesja.



# KOSOVA NË 2017



4 JANAR. Kryetari i Partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj (kryeministri aktual i Kosovës), i cili gjatë kohës së luftës në Kosovë ka qenë njëri nga komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për zonën e Dukagjinit, ishte ndaluar nga autoritetet franceze, bazuar në një urdhër arrest të Serbisë të lëshuar në vitin 2004. Kjo shkaktoi reagime dhe protesta të shumta në Kosovë.



14 JANAR. Nga Serbia nisën një tren, me qëllim të lançimit të linjës hekurudhore Beograd-Mitrovicë. Ky veprim u vlerësua nga pala kosovare si një provokim i rëndë, ku në trenin kishte shënime se Kosova është Serbia, dhe po ashtu kishte motive dhe afishe nacionaliste serbe.



4 SHKURT. Shembet muri ilegal para urës në lumin Ibër, në përputhje me marrëveshjen e arritur mes qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve politikë të serbëve.



7 MARS. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi inicioi projektligjin për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i cili parasheh ndryshimin e mandatit ekzistues të kësaj force në ushtri të Kosovës. Ai e dorëzoi këtë projektligj te kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.



9 SHTATOR. Ramush Haradinaj u zgjodh kryeministër me 61 vota pro dhe qeveria e re e Kosovës u formua nga koalicioni Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA për Kosovën, Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Lista Serbe.



22 TETOR. Mbahen zgjedhjet lokale në 38 komuna të Kosovës. Në zgjedhje morën pjesë 91 subjekte politike, prej tyre 1 koalicion, 35 parti politike, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte akredituar 33 mijë e 200 vëzhgues vendor dhe ndërkombëtar për këto zgjedhje. Këto ishin zgjedhjet e shtata lokale në Kosovë.



# SHQIPËRIA NË 2017



18 SHKURT. Opozita në Shqipëri e udhëhequr nga Partia Demokratike e Shqipërisë filloi një protestë në Tiranë, protestë kjo cila vazhdoi për 3 muaj në çadrën e vendosur në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", në kryeqytetin e Shqipërisë, me kërkesën për dorëheqjen e qeverisë dhe krijimin e një qeverie teknike për organizimin e zgjedhjeve parlamentare.



28 PRILL. Ilir Meta, ish-kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe ish-kryeministër i vendit, zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë president i vendit, pas disa raundesh votimi të dështuara në seancat parlamentare. Meta i cili zëvendësoi në këtë post ish-presidentin Bujar Nishani, zyrtarisht e mori detyrën për mandatin 5-vjeçar presidencial më 24 korrik.



14 QERSHOR. Gianni De Biasi, zyrtarizoi largimin e tij nga drejtimi i Kombëtares së Shqipërisë në Futboll, ndërsa në vend të tij Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) prezantoi në këtë detyrë më 14 korrik Christian Panuccin.



9 SHTATOR. Gramoz Ruçi, deputet i Partisë Socialiste të Shqipërisë zgjidhet kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.



27 NËNTOR. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Kosovës kanë mbajtur mbledhjen e katërt të përbashkët në qytetin e Korçës, ndërsa në përfundim të saj u nënshkruan disa marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi.



1-2 DHJETOR. Shqipëria u përfshi nga moti i keq, me reshje të dendura të shiut në disa qytete të vendit, nduke shkaktuar përmbytje, ku si pasojë u evakuuan qindra persona. Shqipërisë i ofruan ndihmë disa vende nga rajoni, si dhe organizata dhe institucione nga Turqia, për shkak të përmbytje.



15 DHJETOR. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kanë mbajtur takimin e parë të përbashkët ndërqeveritar në Pogradec të Shqipërisë.

# "LITTLE ALBANIA" NË NJU JORK

Nga 200 mijë shqiptarë që kanë imigruar në Amerikë pas viteve '90, një e katërta ka qëndruar në Nju-Jork. Dhe dy të tretat e tyre janë përqendruar në Bronx

Aida CAMA, Nju Jork

Nju-Jorku është stacioni i parë i emigrantëve shqiptarë që vijnë nga Evropa në Amerikë. Një pjesë e tyre qëndrojnë në këtë epiqendër zhvillimi në bregun lindor të kontinentit, shumë të hapur për të sapoardhurit. Pjesa tjetër vazhdon rrugën më tej për të shkuar në thellësi të Amerikës. Nga dyqindmijë shqiptarë që kanë imigruar në Amerikë pas viteve '90, një e katërta ka qëndruar në Nju-Jork. Këta shqiptaro-amerikanë jetojnë në enklava shqiptare nëpër lagjet në Bronx, Staten Island, Queens, Brooklyn, të ngritura sipas zonave prej nga kanë ardhur nga Ballkani.

## "LITTLE ALBANIA"

Dy të tretat e emigrantëve shqiptarë të Nju-Jorkut janë përqendruar në Bronx, ku kanë krijuar "Little Albania" në zonën e Pelham Parkway-it, Morris Parkut dhe Belmontes. Vala e parë e imigrantëve shqiptarë ka ardhur në Bronx në fund të viteve gjashtëdhjetë dhe fillim të viteve '70. Ata u zunë vendin familjeve italiane dhe irlandeze që ikën nga qyteti për një jetë më të qetë në periferi. Zona është kthyer tashmë në një nga komunitetet më popullore shqiptare të Amerikës.

Kur vijnë këtu imigrantët shqiptarë fillojnë punë të çfarëdoshme në ndërtim, restorante, dyqane, pastrim, administrim ndërtesash, shërbim ndaj të moshuarve. Ata që arrijnë një mirëqenie ecin në gjurmët e grupeve të tjera imigrantë. Disa prej tyre kanë ndjekur biznesin me pasuritë e patundshme. Ata kanë blerë ndërtesa banimi gjatë krizës së vitit 1973, kur çmimet e pasurive të patundshme në Bronx ranë shumë, por edhe më vonë. Një e treta e ndërtesave me apartamente në këtë pjesë të Bronxit janë të shqiptarëve. Me kalimin e kohës zonat u zhvilluan, kriminaliteti ra dhe lagjet e Bronxit janë kthyer në qendra komforte për familjarët. Familjet që kanë sukses ndikojnë në zhvillimin e zonës. Por, ashtu siç kanë bërë migrantët e etnive të tjera edhe shqiptarët e sukses-



© DW/A. Cama



Dy të tretat e emigrantëve shqiptarë të Nju-Jorkut janë përqendruar në Bronx, ku kanë krijuar "Little Albania" në zonën e Pelham Parkway-it, Morris Parkut dhe Belmontes

shëm largohen nga Bronxi për të shkuar në zona më të pasura, më të qeta dhe me prosperitet më të lartë. Bronxi mbetet gjithnjë stacioni i parë i emigracionit, kur migrantët kanë shumë nevojë për njëri-tjetrin për fillimin e jetës në vendin e ri.

**Me sigurimin e punës dhe banimit, arsimimi i fëmijëve mbetet një nga prioritetet e prindërve shqiptarë. Pjesa më e madhe e fëmijëve ndjekin shkollat publike, ku mësimi është falas. Kurse në gjuhën shqipe ofrohen pak. Interesimi më i madh mbetet tek integrimi në shoqërinë amerikane**



© A. Cama

## ARSIMIMI I FËMIJËVE PRIORITET

Ndihma që i japin njëri tjetrit migrantët është shumë e rëndësishme sidomos mes shqiptarëve, ku mungojnë organizatat e institucionalizuara në përfaqësimin e interesave. Punësimi, banimi, këmbimi i informacioneve bëhet ende në bazë të lidhjeve familjare dhe shoqërore, shpesh në kafene. Pjesa më e madhe e shoqatave dhe e organizatave merren me kulturë folklorike si ajo e dasmave dhe mexhliëve. Interesimi më i madh i grupit shqiptar të emigrantëve vazhdon të mbetet prosperiteti ekonomik.

## KISHA E SHQIPTARËVE NË BRONX

Me sigurimin e punës dhe banimit, arsimimi i fëmijëve mbetet një nga prioritetet e prindërve shqiptarë. Pjesa më e madhe e fëmijëve ndjekin shkollat publike, ku mësimi është falas. Kurse në gjuhën shqipe ofrohen pak. Interesimi më i madh mbetet tek integrimi në shoqërinë amerikane. Por shoqëria amerikane shihet shumë e kufizuar. Në familjet shqiptare asimilimi ndaj normave kulturore dhe sociale të shoqërisë amerikane është i lejuar. Ky asimilim shkon deri tek përshtatja ndaj obsesionit amerikan ndaj racave. Afinitetin më të madh imigrantët shqiptarë në Nju-Jork e kanë me imigrantët që kanë ardhur nga vendet fqinjë italianë, grekë, boshnjakë. Përzierja shqiptare me racat e tjera mbetet e dëshiruar vetëm brenda "white". Por kjo nuk e pengon brezin e ri, sidomos të lindurit në Amerikë, që të ndjekë rrugën e vet të amerikanizimit. Këtë e sheh për shembull tek rap-istat shqiptarë të Nju Jork, produkti mbase më i suksesshëm i shqiptarëve të Amerikës. (DW)

# Mendo BESIM.

 Sigurime MOTORRIKE

 Sigurime PASURIE

 Sigurime JETË

Mendo

  
UNIQA

+389 2 3288 800  
[www.uniqa.mk](http://www.uniqa.mk)

SIGURIME  
JETË dhe JO-JETË

“Mjekët duhet të monitorojnë mirëqenien psikologjike të pacientëve së bashku me të gjithë parametrat e tjerë të sëmundjes, është e domosdoshme që këto dhimbje të kapen herët dhe të ndërhyhet menjëherë”, thotë Paolo Gritti, president i Shoqërisë Italiane të Psiko-onkologjisë (Sipo), i cili hartoi këtë doracak

# 10 GJËRA QË NUK DUHET T’U THUHEN TË SËMURËVE ME KANCER



Të diagnostikohesh me kancer është gjithmonë një tronditje e madhe. Dhe ndikimi i sëmundjes në mirëqenien psikologjike të pacientëve dhe familjeve të tyre vazhdon të jetë e konsiderueshme në muaj, ndonjëherë në vite dhe në vazhdim. Këtë gjë e kanë treguar vitet e fundit disa studime të kryera në nivel ndërkombëtar: rreth një e treta e njerëzve me kancer (ndërmjet 30 dhe 35%) tregojnë simptoma të stresit dhe shqetësimit psikologjik, sidomos ankthit dhe depresionit. Por si t’i ndihmojmë? Si të bashkëprijmë me ta pa qenë shumë ndërhyrës apo shumë indiferent? “Mjekët duhet të monitorojnë mirëqenien psikologjike të pacientëve së bashku me të gjithë parametrat e tjerë të sëmundjes, është e domosdoshme që këto dhimbje të kapen herët dhe të ndërhyhet menjëherë”, thotë Paolo Gritti, president i Shoqërisë Italiane të Psiko-onkologjisë (Sipo), i cili hartoi këtë doracak.

## 1. MOS I TRAJTONI SI BUDALLENJ OSE SI TË PAAFTË

“Vuajtja të shkurtor dritën, lëreni të besojë se di më shumë se ju” ose “Ju vetëm duhet të pushoni dhe të qëndroni të qetë, ne do t’iu zëvendësojmë dhe do të kujdesemi për angazhimet tuaja”, janë fraza që është mirë t’i shmangni. Edhe nëse vuan, pacienti duhet të ndihmohet të konsiderohet si një person aktiv dhe proaktiv çdo herë dhe që është në gjendje të marrë në konsideratë aspekte të ndryshme të sëmundjes, të marrë vendimet pasuese në dialog me mjekët dhe të afërmit, të mbajë angazhimet e përditshme pa pasur nevojë të kalojë ditët në shtëpi ose në shtrat duke pritur efektet e terapive.

## 2. MOS I DEMORALIZONI

Pa e ekzagjeruar me optimizmin, të sëmurët mund të ndihmohen shumë duke i inkurajuar ata dhe duke u përpjekur të mos e theksojnë shumë pasigurinë për të ardhmen dhe efektet negative të kurave. Forcimi i “shpirtit luftarak” ndaj

sëmundjes është një burim i shkëlqyeshëm për pacientin që duhet të mbështetet nga mjekët dhe anëtarët e familjes. Kuptimi i kancerit si një armik që do të mposhtet duke tërhequr burimet e veta, e bën pacientin plotësisht bashkëpunues me mjekët, të prirur për të mbështetur më mirë efektet anësore të trajtimeve onkologjike dhe optimistë për mundësitë e shërimit.

## 3. MOS I GËNJENI PËR DIAGNOZËN

“Mos u shqetësoni, gjithçka zgjidhet”. “Nuk është një sëmundje e keqe”. “Mjekët nuk e kanë kuptuar ende se për çfarë bëhet fjalë”. Pacienti, nga ana tjetër, ka të drejtë të njohë gjendjen e tij vërtetë nëse e kërkon. Edhe nëse nuk e shprehin këtë kërkesë në mënyrë të qartë, është mirë të kujtojmë se ata që kanë një tumor e njohin shumë herët natyrën e sëmundjes së tyre dhe janë shumë të kujdesshëm për të kuptuar informacionin në lidhje me të. Nuk janë aspak të gatshëm të “luajnë lojën” e atyre që u thonë gënjeshtër: dalin jashtë loje. Heshitja dhe gënjeshtër nuk ndihmojnë në asnjë rrethanë, sepse ata i pengojnë të gjithë njerëzit e përfshirë që të flasin qartë dhe të përballen me vështirësi së bashku, të rrisin izolimin dhe frikën e pacientit dhe, sidomos në situatat më serioze, i mohojnë personit në fjalë mundësinë për të shprehur dëshirat e tij.

## 4. MOS PREMTONI HESHITJE

“Mirë, atëherë u vendos: asnjë prej nesh nuk do të thotë asgjë, më mirë që nuk e di”. Shpesh miqtë, të afërmit, të njohurit, përveç stafit të spitalit, janë të përfshirë në “komplotin e heshtjes”. Familja e pacientit është pre e pikëllimit dhe trishtimit, si dhe duhet të merret

me trajtimin e problemeve të vështira të jetës së përditshme: ata dëshirojnë ta mbrojnë të dashurin e tyre nga ndjenjat dhe problemet negative duke gënjyer për natyrën e sëmundjes dhe pasojat e saj për jetën e të gjithë atyre. Mjekët, infermierët dhe të njohurit duhet të ndihmojnë të afërmit për të ndarë informacionin rreth sëmundjes me pacientin, për kujdesin dhe pasojat e tij praktike.

## 5. MOS BINI NË GRACKËN E GJYSMË TË VËRTETAVE

Është ende shumë e zakonshme që anëtarët e familjes të mbrojnë pacientin duke mos zbuluar diagnozën ose duke përparuar me gjysmën e të vërtetave. Procedimi me gradë mund të jetë një zgjidhje e vlefshme, duke i dhënë kohë personit të interesuar për të metabolizuar lajmet negative pak nga pak, por ajo e së vërtetës së pjesshme duhet të jetë një zgjidhje kalimtare. Sot, shumë studime kanë treguar qartë se shumica e pacientëve me kancer (pavarësisht nga disa dallime kulturore) dëshirojnë të dinë të vërtetën për llojin e kancerit që ai vuan, mbi shanset e rimëkëmbjes dhe rrugën terapeutike që duhet trajtuar. Një situatë e paqartë e komplikon punën e mjekëve dhe shqetëson pacientin, duke e penguar që të merret me qetësi me sëmundjen në familje, ndërkohë që dëshiron të jetë në gjendje të flasë më shumë për atë që po ndodh. Nga hulumtime të ndryshme del qartë gjithashtu se njohja e realitetit të gjërave, nuk çon në dëshpërim dhe nuk rrit stresin e të sëmurëve, por u lejon atyre që të përgatiten më mirë për t’u përballur.

## 6. MOS ELINI TË HESHITË

“Është mirë që të besoni mjekët pa bërë shumë pyetje, se-

pse mendimet e shumta ju bëjnë keq”, është një këshillë e keqe. Pacienti ka shumë dëshirë që të shprehë mendimet dhe emocionet e tij. Mjekët, infermierët, anëtarët e familjes dhe të njohurit duhet t’i kushtojnë kohë të mjaftueshme dëgjimit të pacientit. Ky qëndrim do ta bëjë atë të ndihet i njohur si një person dhe të vlerësohet në përvojën e tij të vuajtjes dhe frikës.

## 7. MOS MIRATONI VENDIMET PËR TRAJTIMET E PAVLEFSHME NGA SHKENCAT MJEKËSORE

“Ne po e provojmë dhe këtë kurë, thonë se ajo bën mrekulli. Mos besoni mjekët që nuk i rekomandojnë këto trajtime vetëm për shkak se nuk njihen nga mjekësia zyrtare”. Ankthi, dëshpërimi, prova e dështimit të kujdesit ndonjëherë e çon pacientin dhe anëtarët e familjes të mbështeten në shërues të paskrupullt ose në terapitë joefektive ose të dëmshme, si alternativa të njohurive të mjekësisë shkencore, që shpesh besohen si mrekulli. Mbështetja e këtyre pritjeve naive tek pacienti dhe tek familjet do të thotë të bëni shpenzime të padobishme dhe madje edhe të udhëtoni, por kjo bëhet një përvojë edhe më e dhimbshme dhe dekurajuese kur këto iluzione gjithashtu do të bien.

## 8. MOS IMPONONI VENDIME TË FUND-JETËS TEK PACIENTI DHE TEK ANËTARËT E FAMILJES

“Bëni këtë, është zgjidhja më e mirë për të dhe për ju”. Kur kura mbaron, sëmundja merr përsipër dhe pacienti merr më të keqen, vendimet e vështira i imponohen atij dhe familjes së tij. Është e këshillueshme që mjekët, miqtë dhe të njohurit të jenë në dispozicion për të dëgjuar nevojat e pacientit

dhe të njerëzve të tij më të dashur, duke u lënë kështu vendimin përfundimtar. Në veçanti, administratorët duhet të parashikojnë të gjitha zgjidhjet e mundshme për rastin individual (nga bujtina në kujdesin shtëpiak, me ndihmën e kurave të ndryshme dhe kujdesit paliativ gjithnjë në dispozicion), duke qenë të gatshëm për të mbledhur shpërthime të momenteve të pashmangshme të dekurajimit, zemërimit, trishtimit, frikës.

## 9. KOLEGË, MIQ, TË NJOHUR MOS E BËNI PACIENTIN TË NDIHET I PADUKSHËM

Shpesh në raste të tilla nuk dini se si të silleni: nëse jepni informacion për sëmundjen dhe rrjedhën e trajtimit, mund të dukeni shumë ndërhyrës, duke heshtur ju rrezikoni të dukeni të pandjeshëm ose indiferentë. E njëjta vlen edhe për miqtë, fqinjët, të afërmit e ngushtë, të njohurit e ndryshëm. Sëmundja i detyron pacientët që të mungojnë në zyrë si dhe të mos frekuentojnë miqtë dhe të njohurit: kthimi në jetën e përditshme është emocionalisht i vështirë. Pacienti ndjehet “i shënuar” nga sëmundja, nga njëra anë dëshiron ta fshehtë dhe në të njëjtën kohë dëshiron ngushëllim dhe praninë. Duke pretenduar se asgjë nuk ka ndodhur për të mund të ketë efekte kundërproduktive, është më mirë ta bëjmë atë të kuptojë se jemi pranë tij në një moment negativ të jetës së tij. Thjesht një: “Përsëritet, si jeni? Si ndiheni?” është qëndrimi më i mirë që pacienti të ndjehet i lirë të shprehë veten, të tregojë ose të heshtë.

## 10. MOS JEPNI KËSHILLA TË PADËSHIRUARA PËR SËMUNDJEN DHE TRAJTIMIN

“Kam lexuar gjithçka rreth tuimoreve. Unë e njoh mirë sëmundjen, kam shumë të njohur të sëmurë. Mos i besoni onkologut të parë që hasni”, janë fraza të papërshtatshme. Pacienti rrezikon të ngatërrohet nga sasia e madhe e informacionit mbi tumoret që qarkullojnë në rrjet ose në rrjetet sociale, të cilave u shtohen edhe vlerësimet e onkologëve dhe opinionet e anëtarëve të familjes. Do të ishte mirë nëse miqtë, kolegët dhe të njohurit nuk do të rritnin babelin e informacionit dhe mendimet që pacienti thith si një sfungjer. Është më mirë të ndihmohet që të reflektojë mbi njohuritë e tij dhe të mbështesë vendimet e tij, duke ofruar lajme dhe mendime vetëm me kërkesë specifike.



## Sfidat me të cilat ballafaqohen vetëm personat me inteligjencë të lartë

Edhe njerëzit me inteligjencë shumë të lartë ballafaqohen me sfida dhe probleme në jetë

- Kanë më shumë presion për të arritur suksese. Dhurata e inteligjencës së lartë i bën njerëzit të ndihen se janë më të mirë sesa tjerët. Ata janë të aftë t'i kuptojnë gjërat të cilat njerëzit e zakonshëm nuk i kuptojnë. Kështu, ata e dinë sa të mençur dhe sa të veçantë janë. Ndërsa pikërisht kjo u bën atyre presion të shënojnë sukses edhe në gjërat më të vogla. Ata duhet të kenë sukses secilën herë, pavarësisht për çka bëhet fjalë. Pas së gjithash, inteligjentët janë më ndryshe se pjesa tjetër e njerëzve, prandaj duhet të jenë më të mirët. Këto gjëra përfshijnë të pasurit një karrierë më të mirë, lidhje më të mira, ose edhe një shtëpi më të mirë. Nëse nuk shënojnë suksese, inteligjentët zemërohen dhe fillojnë ta kritikojnë vetveten.

- Krijimi i miqësive nuk është gjë e lehtë për ta. Inteligentët gjithmonë duan të bëhen miq vetëm me njerëz që u ngjasojnë vetë atyre. Kur flasin me njerëz të ri, me qëllim u bëjnë pyetje të mençura për të parë se cilat janë përgjigjet e tyre. Kështu e kuptojnë nëse personi përballë e meriton miqësinë e tyre. Pikërisht kjo është arsyeja se përse inteligjentët shpeshherë janë të vetmuar, sepse nëse nuk e gjejnë dikë po aq të mençur sa vetë, ata qëndrojnë të vetmuar.

- Analizimi i tepërt e bën më të vështirë marrjen e vendimeve. Personat të cilët kanë inteligjencë shumë të lartë, në përgjithësi hulumtojnë shumë para se të marrin ndonjë vendim, qoftë edhe për gjërat më të vogla. Por, përderisa kjo mund të jetë gjë e mirë, njëkohësisht i ka edhe të metat e veta. Analizimi i tepërt ua vështirëson inteligjentëve të marrin vendime.

# LUXTURNA, ILAÇI QË KUSHTON MË SHUMË SE 1 MILIONË DOLLARË



Javën e kaluar Administrimi i Medikamenteve dhe Ushqimeve e njohur ndryshe si FDA në Amerikë miratoi licencën që në vitin 2018 të tregtohet një ilaç i njohur me emrin tregtar si Luxturna (emri farmaceutik - voretigene neparovovec) që ka thyer dy rekorde. E para është se përfaqëson medikamentin e parë që miratohet për një çrregullim genetik të lindur dhe e dyta se do të kthehet ndoshta në ilaçin e parë që do të kushtojë më shumë se 1 milion dollarë.

**SËMUNDJA E LEBERIT.** Njihet ndryshe si amauroza kongenitale e Leberit. Kjo sëmundje prek retinën dhe ndodh 1:40.000 lindje. Në 10% të rasteve ekziston një mungesë e genit RPE65 (retinal pigment epithelium), ky gen bën që të prodhohet një enzimë që u lejon qelizave të retinës të prodhojnë një pigment të quajtur rodopsina, e cila na shërben për të parë në errësirë. Fëmijët me sëmundjen e Leberit të lindur me

genin RPE65 difektoz nuk mund të formojnë dot radopsinën dhe kanë vështirësi për të parë në mjedisë pak të ndriçuar. E humbin progresivisht shikimin dhe mbeten të verbër në moshën 40 vjeç.

**TERAPIA GJENETIKE.** Duke ditur që sëmundja e Leberit shkaktohet nga një mutacion i një geni të vetëm, disa shkencëtarë prej kohësh janë përpjekur për të gjetur një metodë që t'u lejojë zëvendësimin e genit difektoz me një tjetër të shëndetshëm. Në vitin 2007 shkencëtarët amerikanë dhe anglezë publikuan studimet e para, në të cilin kishin futur një gen RPE65 brenda një virusi me idenë për ta përdorur si një mjet ose vektor për të futur kopjen e shëndetshme të genit në genom dhe qelizave retinale duke zëvendësuar genin jo normal. Kjo teknikë e të përdorurit të një virusi si vektor është baza e trajtimeve gjenetike dhe procedura e injektimit të virusit në inde vepron si një kalë

Troje dhe quhet transduktim. Duke qenë se është e rrezikshme injetimi i një virusi të modifikuar që mund të penetrojë në qelizat normale, shkencëtarët bëjnë ndryshime në proteinat e membranës së virusit, duke i bërë më specifike që të mund të penetrojnë genin e ndryshuar. Në vitin 2009 shkencëtarët e Filadelfias publikuan një studim sipas të cilit fëmijët dhe të rriturit me sëmundjen e Leberit mund të rikuperonin shikimin.

## MEDIKAMENTI 1 MILION DOLLARË.

Edhe pse udhëzimet e laboratorit Sparks, prodhuesit e këtij medikamenti, thonë se do ta vendosin çmimin muajin e ardhshëm dhe se Instituti i Rishikimeve Klinike dhe Ekonomike të Medikamenteve (ICER) do ta vendosë çmimin në 25 janar 2018, analistët e Wall Street-it e kanë vlerësuar se ky do të jetë medikamenti i parë që do të kushtojë më shumë

E para është se përfaqëson medikamentin e parë që miratohet për një çrregullim genetik të lindur dhe e dyta se do të kthehet ndoshta në ilaçin e parë që do të kushtojë më shumë se 1 milion dollarë

se 1 milion dollarë. Sigurisht që ky supozim ka shkaktuar shqetësim si në Amerikë edhe në Evropë, aq më tepër nëse çmimi i Luxturnës nuk e justifikon efektin e saj të përkohshëm. Llogaritet se Sparks do të fitonte 78 milionë dollarë në vitin 2018, 238 milionë në 2019 dhe 445 milionë në vitet në vazhdim.

**ARSYETIM.** Meqë terapia gjenetike ka bërë hapa prej gjigandi janë hapur fjalë se ka një kurë për hemofilinë dhe se çmimet e medikamenteve duke nisur nga Luxturna do të jenë astronomike, Qendra e Politikave Margolis në Universitetin Duke mbledhi shkencëtarë, shoqëri sigurimesh shëndetësore dhe industrinë farmaceutike që të mund të diskutohet sesi ta zgjidhin këtë problem. Pyetja shtrohet: Pse krijojnë një ilaç që askush s'është në gjendje ta blerë? Nuk ka dyshim se kjo është një temë për të cilën do të flitet gjatë në vitet në vazhdim, por tani as që duhet ta imagjinojmë çfarë do të ndodhte nëse një fëmijë shqiptar diagnostikohet me sëmundjen e Leberit dhe ka nevojë për Luxturnën.

## Ushqimet që nuk duhet ngrohur

Nëse e keni lënë ushqimin që nuk doni ta hidhni, ruani atë në të ftohtë për një ditë tjetër. Para se ta bëni këtë, është mirë të dini se cilat ushqime nuk duhet të ngrohen. Nuk është e nevojshme të përmendet se ngrohja e ushqimit nuk rekomandohet pasi lirohen komponimet toksike. Spinaqi, panxhari, selino përmbajnë nitrate të cilat nën veprimin e mikroorganizmave dhe ngrohjes kalojnë në komponimet e nitrateve, të cilat janë të dëmshme dhe kancerogjene. Spinaqi

është më i rrezikshmi në këtë grup dhe gjithmonë ai duhet konsumuar në formë të freskët. Kërpudhat për shkak të proteinave të tyre ndryshojnë lehtë dhe bëhen të dëmshme. Ato rekomandohet të ngrohen vetëm pak. Patatet në rast të ngrohjes humbasin vetitë ushqyese dhe hulumtimet e fundit kanë treguar se ato janë gatimi më i shëndetshëm, por në gjendje të ftohur. Gjegjësish, kur patatet ftohen, përqindja e niseshtes rezistuese që ka aktivitetin probiotik rritet.



FOTOT QË PO BËJNË  
XHIRON E BOTËS

## TË LINDËSH, RRITESH DHE TË MBIJETOSH NË MES TË LUFTËS

Miliona fëmijë po paguajnë një çmim indirekt për këto konflikte, duke vuajtur nga kequshqyerja, sëmundjet apo traumat nga gjërat që shohin

Të lindësh në luftë nuk është aspak e lehtë për askënd. Janë me miliona fëmijë të cilët kanë lindur në luftë. Ata kanë hedhur hapat e parë mes bombardimeve. Kanë nisur të flasin fjalët e para ndërsa jeta e tyre nuk është e sigurt. UNICEF ka paralajmëruar se fëmijët janë sulmuar në mënyra tronditëse gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa grupet e konflikteve i kanë shkelur me këmbë ligjet ndërkombëtare të hartuara për të mbrojtur të vegjëlit. Foshnje të porsalindura, të cilët nuk kanë arritur ende të ecin me këmbët e tyre, janë bërë objektiva në vijën e frontit, të përdorura si mburoja njerëzore, janë vrarë apo rekrutuar për të luftuar, tha organizata humanitare. Përdhunime, martesat të detyruara, rrëmbime e skllavërime janë kthyer në taktika standarde në konfliktet e zhvilluara nga Iraku, Siria dhe Jemeni, e deri tek Nigeria, Sudani Jugor apo Mianmar. Në disa kontekste, fëmijët e rrëmbyer nga grupet ekstremiste përjetojnë abuzime të shumta, derisa shpëtohen nga forcat e sigurisë. Miliona fëmijë po paguajnë një çmim indirekt për këto konflikte, duke vuajtur nga kequshqyerja, sëmundjet apo traumat nga gjërat që shohin.


Drejtori i Programeve të Emergjencave të UNICEF-it, Manuel Fontaine tha se fëmijët janë kthyer në shënjestër dhe janë ekspozuar ndaj sulmeve dhe dhunës brutale në shtëpitë, shkollat apo parqet e tyre të lojërave. "Një brutalitet i tillë është po shndërruar në jetesë më se normale për to, dhe ne nuk mund të qëndrojmë duarkryq". E gjithë kjo gjendje e trishtë e fëmijëve që lindin e rriten në luftë ka ardhur e pasqyruar nëpërmjet një seti fotografik i realizuar gjatë vitit 2017 në vendet ku zhvillohet luftë.



FUTBOLLI GJATË VITIT 2017



# VIT PËR TU MBAJTUR MEND



Viti për tu mbajtur mend. Shpresat e përfaqësueses së Maqedonisë deri 21 vjeç u plasuan në Kampionatin Evropian në Poloni, në Shkup erdh Milani, u mposht Fenerbahçe, derisa kishim edhe Superkupën e Evropës

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 29 dhjetor - Po kalon një vit për tu mbajtur mend për futbollin në Maqedoni. Për herë të parë ishim pjesë e Kampionatit Evropian për futbollist deri 21 vjeç, skuadra e Shkëndijës e solli Milanin në Shkup, Vardari e eliminoi Fenerbahçen dhe u plasua në Grupet e Liga Evropës. Dhe jo vetëm kaq, por në Shkup i kishim në Shkup edhe Real Madridin e Manchester Junajtedin, si pjesë e Superkupës së Evropës. Në vazhdim do të rikujtojmë edhe njëherë këto ngjarje të mëdha që ndodhën në vitin 2017.

**U-21 NË KAMPIONATIN EVROPIAN**

Heronjtë më të rinj të futbollit dhe në përgjithësi sportit në vendin tonë për vitin 2017, pa dyshim që janë shpresat e përfaqësueses së Maqedonisë. Të udhëhequr nga seleksionuesi dhe punëtori I palodhshëm, Bobi Milevski, të rinjtë e Maqedonisë arritën suksesin më të madh në historinë e futbollit tonë, duke u plasuar në Kampionatin Evropian të shpresave, i cili u mbajt në Poloni. Fitorja 2-0 ndaj Skocisë dhe para se gjithash humbja në shtëpi e Islandës nga Ukraina me 4-2, e dërgoi Enis Bardhin me shokët në Evropian, si të parën e grupit të tretë kualifikues, me 22 pikë nga 10 ndeshje, duke u renditur edhe para Përfaqësueses së Francës, që pose-



donte një formacion me vlerë prej 110 milion eurosh, apo edhe para ekipeve si Islanda, Ukraina, Skocia dhe Irlanda e Veriut. Me këtë sukses historik, ekipi i shpresave u bë e para skuadër futbollistike e vendit tonë, që luajti në një kampionat evropian. Për këtë, Federata e Futbollit të Maqedonisë ndau 200.000 euro shpërblim. Ndërkohë, Maqe-

donia e përfundoi pjesëmarrjen e saj në pozitën e katërt, ndërsa golin e parë historik në këtë eveniment e shënoi Enis Bardhi.

**SHKËNDIJA SJELL MILANIN NË SHKUP**

Shorti ka qenë "engjëll dhe djall" për Shkëndijën e Tetovës. Kuqezinjtë janë ndeshur kundër gjigantëve italianë të Milanit në



kuadër të ndeshjes së Liga Evropës. Shanset për kualifikim padyshim që ishin thujtë të papërfillshme për të besuarit e Qatip Osmanit përballë milionave të kinezëve të Milanit, por reklama që iu bë nga kjo përballje kuqezinjve, ka qenë shumë e madhe, ndoshta edhe më e madhe edhe në rast se do të ishin kualifikuar në grupe. Ndryshe, ashtu siç pritej, gjiganti italian, Milani ka shënuar fitore të thellë 6-0 në "San Siro" në një ndeshje ku prezent ishte edhe grupi i tifozëve "Ballistët", ndërsa në ndeshjen kthyesë në Shkup, kuqezinjtë triumfuan minimalisht me 0-1.

**VARDARI ELIMINON FENERBAHÇEN, KUALIFIKOHET NË GRUPET E "EUROPA LEAGUE"**

Vardari u bë skuadra e parë nga Maqedonia që luajti në grupet e një kompeticioni evropian nën ombrellën e UEFA-s. Pas eliminimit nga ndeshjet eliminatorë të Ligës së Kampionëve, kampioni aktual i Maqedonisë në ndeshjen e fazës së "play-off" të Liga Evropa arriti të eliminojë gjigantin turk Fenerbahçe. Ishte ky një sukses i madh i Vardarit dhe në përgjithësi për futbollin e Maqedonisë, pasi për herë të parë një skuadër nga Maqedonia kishte mundësi të sheh ndeshje në

kuadër të grupeve të Liga Evropës. Sa i përket pjesëmarrjes në këtë kompeticion, Vardari i përfundoi me vetëm një pikë dhe pesë disfata, duke u bërë skuadra më e dobët nga 48-të skuadra tjera.

**SUPERKUPA E EVROPËS**

Federata e Futbollit të Maqedonisë pasi fitoi besimin e UEFA-së për organizimin e duelit ekskluziv ndërmjet fituesve të Ligës së Kampionëve dhe Liga Evropës të sezonit garues 2016/2017, kishte bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e këtij evenimenti, më të madh që ndonjëherë ka ndodhur në Maqedoni. Pasi i kishte bërë gjitha përgatitjet paraprake, FFM dhe stafi tjetër organizativ ishte i gatshëm që me 8 gusht ti pret dy gjigantët e mëdhenj të futbollit Manchester Junajtedin, e cila fitoi Liga Evropën dhe Realin e Madridit e cila triumfoi në Ligën e kampionëve. Beteja mes dy klubeve më të vlefshme në futbollin botëror u mbyll 2-1 në dëm të "Manchester United përballë 33 mijë spektatorëve në kryeqytetin e Maqedonisë, Shkupin që admiruan sfidën e parë të vërtetë të këtij sezoni. Ndërkohë, nëpërmjet rrjeteve zyrtare sociale, UEFA falënderoi Shkupin dhe Maqedoninë për pritjen duke potencuar organizmin fantastik të Superkupës 2017. "Faleminderit Shkup, Maqedoni. Nikoqir fantastik të Superkupës 2017", thuhej në mesazhin e UEFA-deri te opinioni sportdashës në Maqedoni. Derisa, edhe të parët e FIFA-së dhe UEFA-së, Xhani Infantino dhe Aleksandar Çeferin menjëherë pas spektaklit, para kryetarit të Federatës Futbollistike të Maqedonisë, Ilčo Gjorgjoski dhe kryeministrit të Maqedonisë Zoran Zaev, potencuan kënaqësinë nga organizimi i shkëlqyer të njërit prej ngjarjeve më të mëdha botërore në aspektin e klubeve këtë vit.

Vitin 2017 po e përcjellim me shpresë se edhe viti 2018 do të na sjell suksese të mëdha, si në aspektin e klubeve, poashtu edhe në ato individuale.

RRËFIMI I GJATË I KRISTIAN PANUÇIT



# MË PËLQEN TË RREZIKOJ,

# SHQIPËRINË E ÇOJ NË "EURO 2020"

Kristian Panuçi është rrëfyer në një intervistë të gjatë për gazetarin Alban Xhiani, në "Supersport", ku ka treguar si nisi aventura e tij kuqezi, ndeshjet në krye të kombëtares shqiptare, pritshmëritë në fushatën kualifikuese për "Euro 2020" etj etj...

**- Si ka qenë periudha e parë e Vitit 2017, a e kishit menduar ndonjëherë se mund të preknit Shqipërinë?**

**Panuçi:** Në vitet e mëparshme, kombëtarja shqiptare që udhëhiqej nga Xhani De Biazi, ishte rritur shumë. Imazhi i Kombëtares Shqiptare ishte një kombëtare e rëndësishme, sepse mori pjesë në Evropian. Kur më erdhi telefonata sinqerisht nuk dyshova kurrë që të vija të stërvitja Shqipërinë, edhe pse mendoja që ishte skuadër e mirë. Tani që po e drejtoj prej gjashtë muajsh, jam akoma më i bindur se zgjedhja që bëra ishte e duhura.

**- Si lindi ideja për të bashkëpunuar me FSHF-në? Kur ishte hera e parë që dëgjuat fjalën Shqipëria?**

**Panuçi:** U kontaktova në telefon nga drejtori, Denis Bastari, i cili më kërkoi një takim për të ndarë disa ide, unë, bashkë me trajnerë të tjerë, besoj. Erdha në Tiranë, u takova me presidentin Duka. Biseduam, shkuam bashkë për drekë, që aty, pas 20 ditësh, më kontaktoi Duka ku më tha që më kishte zgjedhur mua. Pra, isha trajneri i ri i Shqipërisë.

**- Ishin edhe 2-3 kandidatura të tjera, ishte Sidorf, Inzagi. Përse**

**mendon se u përzgjedhët ju?**

**Panuçi:** Për këtë duhet pyetur Dukën. Unë besoj se është njeri që bazohet te ndjesitë, është biznesmen i madh dhe ndoshta ka perceptuar diçka. E vetmja gjë që mund të bëj dhe bashkëjetoj çdo ditë, është se duhet t'i jap të drejtë. Shpresoj t'i jap të drejtë në dy vitet e punës që më presin këtu në Shqipëri dhe të arrij rezultatin më të rëndësishëm, Euro 2020. Kam dëshirë dhe vullnet t'i jap të drejtë Dukës për zgjedhjen e tij. Do të ishte gjëja më e bukur që mund të marr këtu, në Shqipëri.

**- Nuk i thatë diçka për ta bindur Dukën? Ndoshta kjo do të ishte diçka interesante.**

**Panuçi:** Jo, s'kam bindur kurrë. Kam tentuar gjithnjë të jem vetvetja. Nuk i kam telefonuar kurrë askujt. Shpreha thjesht karakterin tim, dëshirën time për të punuar, mënyrën time të menduarit. Besoj se isha një lojtar që e bëra me seriozitet karrierën time. Dhe me po këtë seriozitet dua të bëj karrierë si trajner. Besoj se në jetë duhet të jesh gjithnjë vetvetja, të mos blofosh kurrë, sepse zbulohen të gjitha letrat.

**- Keni qenë ndihmëstrajner te Rusia. Çfarë përshtypjesh të ka lënë kjo eksperiencë dhe a ndryshojnë shumë ambientet në Rusi dhe Shqipëri?**

**Panuçi:** Atje isha ndihmëstrajner, edhe pse punoja shumë në fushë. Ishte një përvojë fantastike përkrah Fabio Kapellos, Italo Galbiati. Ishin dy vite e gjysmë shumë të bukura në Rusi, punova mirë, u ndjeva mirë, më ndihmoi të rritem

profionalisht, sepse të rrih pranë trajnerit që bën disa zgjedhje, arsyeja pse i bën, si i bën, më rriti shumë profesionalisht dhe ishte një përvojë tepër e rëndësishme.

**- Shqipëria një vit më parë kishte marrë pjesë në Evropian, kur e pranuat këtë detyrë a kishit frikë se po rrezikonit?**

**Panuçi:** Më pëlqen të rrezikoj. Nuk më shqetëson kjo. Kur e mora kombëtares, objektivi ishte 2020. Në katër ndeshjet e mbetura duhej të njihja grupin, se kush ishte Shqipëria, federata. Këta 6 muaj ishin shumë të rëndësishëm për të njohur të gjithë mekanizmin shqiptar, në aspektin e futbollit.

**- De Biasi kur mori Shqipërinë bëri një lloj revolucioni, ndërsa ju gjetët një skuadër të mirë. Megjithatë pati disa ndryshime në seleksionimin e futbollistëve dhe në mënyrën e lojës.**

**Panuçi:** Sa herë që bënim stërvitje, dalloja diçka në skuadër. Kisha gjithnjë përshtypjen që kjo skuadër mund të luante 15-20 metra më përpara. U mundova gjithnjë t'i inkurajoja. Besoj se ky është një vend që e ka vuajtur shumë diktaturën e viteve '80. Kur vija me avion dhe më pas lëvizja me makinë drejt qendrës, shihja lokalet dhe njerëzit që e kalonin ditën me lehtësi të madhe. Këtë doja t'i transmetoja skuadrës. Kurajën për të tentuar, për të bërë 15-20 metra. Kemi ende shumë punë për të bërë, por besoj se në Turqi u pa një skuadër e guximshme dhe që tenton ta fitojë ndeshjen. Nëse kundërshtari është më i zoti, i japim dorën dhe kthehem në shtëpi.

Ideja ime është të provojmë të bëjmë lojën tonë.

**- Në ditën e parë të grumbullimit, latë Xhakën dhe Cikalleshin jashtë, por koha tregoi se ju nuk kishit asgjë personale me këta futbollistë. Çfarë është disiplina për ju dhe a keni një grup të disiplinuar?**

**Panuçi:** Po, gjeta një grup me djem shumë seriozë. Por kishte gjëra për t'u sistemuar. Besoj se kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Janë oraret, respekti. Kur një lojtar vjen në kombëtare, duhet të kuptojë që përfaqëson kombin e tij. Kombëtarja është diçka shumë e rëndësishme. Tentova të bëj normalitetin e gjërave që kam jetuar vetë. Oraret. Një lojtar s'mund të vijë me një ditë vonesë për arsyet e tij personale. Cikalleshi është lojtar i rëndësishëm, gjithashtu dhe Xhaka, por ka disa rregulla. Pa rregullat, nuk shkojmë askund. Nuk arrihet asnjë rezultat.

**- Katër pikë në katër ndeshje zyrtare. Sa i kënaqur jeni me pikët që ka grumbulluar skuadra? Nuk beson se keni zhgënjime?**

**Panuçi:** Besoj se si performancë erdhëm në rritje, gjithmonë në rritje. Pengu i vetëm është pika me Italinë. Spanja është i një niveli tjetër. Mendoj që edhe nëse përballemi me Italinë në kualifikueset për Evropianin apo çfarëdo që ndodh, do të luajmë. Do të luajmë sepse po ndërtojmë një grup cilësor, një grup që ndoshta vetëm Gjermania dhe Spanja janë sipër nesh, por mendoj se kemi një skuadër që mund të përballlet me të gjithë.

**- Transferta me Maqedoninë për ne ishte si një finale, na duhej barazimi dhe e morëm. Mendon që kishte diçka që nuk shkoi në atë ndeshje? E kam fjalën zëvendësimet që u kryen menjëherë në pjesën e dytë.**

**Panuçi:** Ne duhet të punojmë më shumë në aspektin kur nuk e kemi topin. Në shumicën e rasteve e marrim me të lehtë. Pësuam disa gola, për shembull në Turqi, shumë lehtësisht. Në Maqedoni pësuam gol me penallti. Kishim avantazhin 2-0, por besoj se skuadra ka ndryshuar totalisht edhe me lojtarët. Besoj se ndonjë gol mund ta shmangnim.

**- Nuk arritëm të merrnim pikë përballë Italisë. Edhe pse Italia nuk u përpoq fare për të fituar, sërisht fitoi. Koha tregoi që Italia kishte probleme, nuk shkoi në Botëror.**

**Panuçi:** Jam i bindur që po të tregoheshim më mizorë s'do ta humbnim atë ndeshje. Ne mbetëm jashtë botërorit, pësuam një gol që mund ta shmangnim. Na vjen keq, por duhet të shohim përpara. Jam i bindur se pikën që humbëm me Italinë do ta rimarrim në kualifikueset e 'Euro 2020'.

**- Viti u mbyll me një fitore 2-3 në miqësoren me Turqinë. A ishte një mesazh se kjo skuadër mund të fitojë edhe ndaj kundërshtarëve më të mirë në renditjen e FIFA-s?**

**Panuçi:** Besoj se ishin dy ndeshje. Pjesa e parë, fitorja e lojës. Sepse luajtëm vërtet futboll. Pjesa e dytë, e karakterit. Thuhet që trajneri është një trajner karakteri.



Nëse i dhashë karakter kombëtares, më bëhet qejfi, sepse jam një njeri dhe trajner që nuk tërhiqet kurrë, deri në minutën e 95-të, deri në stërvitjen e fundit, deri në sekondën e fundit të çdo stërvitjeje. Dua që lojtarët e mi të kenë atë ndjesi. Të japin maksimumin në çdo stërvitje, të mundohen të përmirësohen dhe kur bëhet ndeshja, të marrin me vete fitoren në shtëpi. Kjo është rruga e duhur në atë që duam të ndërtojmë, në grupin që duam të formojmë për të shkuar në Euro 2020.

#### - Ku jetoni momentalisht?

**Panuçi:** Unë jetoj në Romë. Në këtë periudhë kam shëtitur nëpër Evropë, vij gjithmonë me shumë dëshirë në Shqipëri. Por në Romë punoj, nuk jam me pushime. E kam obsesion 'Euro 2020'. Tani do të kalojmë pushimet e Krishtlindjes dhe pastaj do të shohim ata 4-5 lojtarë që po vëzhgoj.

#### - A mendoni se Shqipëria mund ta fitojë grupin e saj me tre ose katër skuadra në Ligën e Kombeve, që nis në shtator?

**Panuçi:** Ne jemi të bindur se kemi një skuadër që mund ta fitojë grupin, sepse ne duhet të mendojmë gjithmonë që mund ta fitojmë, por edhe skuadrat e tjera e mendojnë, ndaj do të jenë detajet e vogla, ambicia, dëshira për të shkuar në Euro 2020 që do të bëjë ndryshimin. Ne do të krijojmë një grup që do ta provojë, por nëse të tjerët do të jenë më të zotët, do ta pranojmë. Por para se të eliminohet Shqipëria, të tjerët duhet të luftojnë, ashtu siç do të luftojmë ne.

#### - Cilat skuadra do të përzgjidhje si kundërshtarë nëse do të bënim një simulim për krijimin e grupit?

**Panuçi:** Nuk dua të zgjedh asnjë, sepse kam qenë gjithnjë i pafat në zgjedhje. Unë do të zgjidhja më tepër Slloveninë. Do të zgjidhja Finlandën, pastaj Qipron. Atje është vapë dhe djemtë. Më mirë në vende të nxehta.

- Përveç Ligës së Kombeve janë edhe ndeshjet kualifikuese të Evropianit. Mendoni se do t'ju përndjekë fakti që me De Biasin, Shqipëria u kualifikua, pra do të keni më shumë presion?

**Panuçi:** Presioni nuk frikëson aspak. Duhet të kemi karakter, personalitet, të dimë t'i menaxhojmë këto situata dhe të mendojmë se me Xhanin ishte një histori e bukur, sepse Xhani bëri një punë të shkëlqyer, tani duhet të ndërtojmë një histori tjetër të bukur dhe ndoshta ndonjëherë bëhet më e bukur. Shpresoj të jetë një përrallë e bukur. Jam i bindur se po mëkëmbim një skuadër që mund t'i pëlqejë të gjithë kombit, të gjithë Shqipërisë.

#### - Ju jeni një ish-futbollist i madh që keni luajtur me ekipe të mëdha. Pak e vogël Shqipëria, nëse e krahasoni me karrierën tuaj të mrekullueshme.

**Panuçi:** Jo, Shqipëria është krenarie madhe për mua. Jam krenar që e stërvit Shqipërinë. Ajo që kam bërë si futbollist, s'do të thotë absolutisht asgjë. Jam shumë i lumtur që e stërvit këtë skuadër dhe kam shumë dëshirë ta përçoj karakterin, dëshirën time ndaj këtyre lojtarëve për të parë çfarë ka mbrapa murit për të tentuar të fitojmë ndeshjet. Jam i privileguar. Kur erdha në Shqipëri dhe fola me presidentin, nuk kam diskutuar kurrë për 1 euro. Nuk më interesonin aspak paratë. E dija që ishte një produkt ku mund të bëja punë të mirë. Tani, pas 6 muajsh, jam akoma më i bindur për zgjedhjen që bëra.

#### - Në vitin 1993 ju keni ardhur në Shqipëri si lojtar. Luante Olimpiku i Tiranës me një skuadër ushtarake italiane.

**Panuçi:** Mbjaj mend dhe ishte një udhë-

tim, më falni që po e them, i trishtuar. I trishtuar, sepse kur erdha në aeroport, ishin fëmijët që më kërkoni panin jashtë autobusit dhe ishte një imazh që më preku në zemër. Kur shoh tani, pas kaq shumë vitesh, që Shqipëria e mori veten në këtë mënyrë dhe ka dëshirë për t'u rritur, ka një ekonomi që po rimëkëmbet, është shumë bukur. Por më kujtohet ai autobus kur po dilja nga aeroporti dhe fëmijët që më kërkoni një panin. Unë që jam baba, mundohem. Ndoshta tani ndiej më shumë trishtim. Ndoshta në atë çast nuk e kuptoj sesa shumë ka përparuar ky vend gjatë këtyre viteve.

#### - Po tani si është të jetosh në Shqipëri? Ju jeni akomoduar në një hotel.

**Panuçi:** Unë ha shumë mirë, problem është kur drekoj me presidentin. Presidenti ha, më detyron të ha shumë. Ndihej mirë, rri në hotel, shkoj te federata, punoj. Edhe kur isha futbollist, e shumta në orën 23:00 flija gjumë. S'jam tip që jetoj. Më pëlqen të shkoj në restorant, të pi një verë të mirë, e adhuroj këtë lloj jete. Kur jam këtu, punoj, punoj gjithmonë.

#### - Çfarë të pëlqen nga ushqimet tradicionale shqiptare?

**Panuçi:** Provova kuzhinën dhe disa gatime, por nëse më pyet për emrat, nuk i mbaj mend. Por këtu hahet shumë mirë. Hëngra peshk në Durrës me presidentin. Hahet shumë mirë. Pas marsit dua të bëj një xhiro në jug të Shqipërisë për ta njohur, për të krijuar një përshlyetje. Sepse praktikisht, kur vij këtu ndihem mirë. Dua të perceptoj dhe kuptoj gjithçka në lidhje me Shqipërinë.

#### - Çfarë mendon familja juaj, partnerja juaj, për këtë eksperiencë?

**Panuçi:** Kam një baba dhe një nënë që s'kanë ndërhyrë kurrë në jetën time. Kanë tentuar gjithnjë... Po tentoj t'i mësoj tim biri që të jetë i lumtur. Nëse im bir do të jetë i lumtur të bëhet picier, do të bëhet picier. Do ta dalloj në sytë e tij nëse do të jetë i lumtur. Prindërit janë të lumtur sepse shohin një bir të lumtur me punën që po bën, të lumtur që punon në Shqipëri dhe kur prindi e sheh fëmijën të lumtur, lumturohet edhe ai, çfarëdo qoftë. Im bir ndihet shumë krenar, është tifoz i parë i Shqipërisë, ma ndien mungesën dhe po kalojmë një çast të bukur.

#### - Djali juaj mund të bëhet një Panuçi i ri?

**Panuçi:** Pyetja që i bëj gjithmonë. Ai luan në një skuadër afër Romës. Kur vjen në shtëpi, e pyes gjithnjë: 'A u kënaqë? U zotove? Im bir e ka shumë të vështirë në Romë. Në thonjza, 'Të jesh Panucci'. Dua vetëm që të dëfrehet, të rrijë në një ambient të begatë dhe që të luajë futboll. Pastaj, se çfarë do të ndodhë dhe se ç'do dojë të bëjë, do ta vendosë ai. Nuk do t'i them unë çfarë të bëjë. Nëse do të bëhet picier, avokat, inxhinier, duhet të jetë i lumtur ai. Unë dua vetëm lumturinë e tij.

#### - Flet shqip?

**Panuçi:** Jo, por do të mësoj. Jo, s'e kam mësuar. Do më ndihmohet? Gëzuar festat të gjithë shqiptarëve!

#### - Ku do t'i kalosh festat e fundvitit?

**Panuçi:** Do të shkoj në Amerikë. Në Majami. Sepse shkoj atje prej 25 vjetësh, kam shtëpinë, kam miqtë e ngushtë, do të nisem me tim bir dhe do të shkoj në Amerikë.

#### - Faleminderit, mister shpresoj t'ia arrish objektivit dhe të gëzosh të gjithë shqiptarët.

**Panuçi:** Të falënderoj dhe do të bëjmë çmos që ta çojmë Shqipërinë në Euro 2020.



## 10 THËNIE TË MURINJOS PËR "ARMIQTË"!

Hoze Murinjo, krahas faktit që është trajner fitues dhe ndër më të paguarit mes kolegëve në të gjithë planetin është një personazh shumë i dashur për gazetarët, sepse deklaratat e tij ironike dhe plot sarkazëm kanë bërë shpesh herë xhiron e botës

Nga Leo Messi te Kristiano Ronaldo, nga Arsen Venger te Rafa Benitez, pa harruar "viktimën" e tij të preferuar Klaudio Ranieri. Ja cilat kanë qenë 10 "sulmet" më të famshme të portugezit

#### Lionel Messi

"Si thuhet "hileqar" në spanjisht?! Barcelona është një qytet me kulturë të madhe, e mbushur me teatro dhe ky djalosha ka mësuar shumë mirë si duhet të luaj pjesën e tij si aktor". Hoze Murinjo foli në këtë mënyrë për Leo Messi, që sipas tij kishte shkaktuar kartonin e kuq të marrë nga Del Horno, më 22 shkurt 2006, pas ndeshjes Çells-Barcelona 1-2, e vlefshme për çerekfinalin e Ligës së kampionëve.

#### Kristiano Ronaldo

"Si trajner e kam nisur punën në vitin 2000. Më parë kam qenë ndihmës trajner në klube të mëdha dhe me trajnerë të mëdhenj. Kam punuar me futbollistët më të mirë në botë. Kur isha 30 vjeç stërvitja Ronaldon, jo Kristianon, Ronaldon e vërtetë, brazilianin". Ky ishte "thumbi" ndaj "CR7", "ylli" i Real Madridit, në 3 gusht 2013, dy muaj pas largimit nga "Bernabeu". Dy portugezët nuk u bënë për asnjë moment miq me njëri-tjetrin.

#### Arsen Venger

"Tetë vjet pa fituar asnjë trofe janë shumë. Nëse unë do të kisha bërë të njëjtën gjë te Çells, do të isha larguar prej kohësh. E respektoj si trajner, por nëse do të flasim për sukseset e arritura, situata është e qartë. Ai është specialisti i falimentimeve". Murinjo e sulmoi në këtë mënyrë Arsen Venger, më 14 shkurt 2014. Në fund të sezonit, Arsenalin ndali "agjërimitin", duke fituar Kupën e Anglisë.

#### Pietro Lo Monaco

"Lo Monaco? Unë njoh murgjit e Tibetit (në italisht: Monako), Principatën e Montekarlos (Monako), Bajern Munich (në italisht: Bajern Monako), Çmimin e Madh të Formulës 1 në Montekarlo (Monako). Nëse ky Lo Monaco do të bëhet i famshëm duke folur për mua, atëherë duhet të më paguajë." Më 15 shtator 2008, Mou iu përgjigj në këtë mënyrë drejtorit sportiv të Katanis që kishte thënë për "Special One": "Është një nga ata që nuk ngopesh duke e rrahur".

#### Pep Guardiola

"Guardiola është një trajner fantastik, por unë kam fituar dy herë 'Champions League' me Porton dhe Interin. Ai ka fituar një 'Champions' për të cilën mua do të më vinte turp dhe mund të fitojë një tjetër, që sërish është e turpshme". Në 28

prill 2011, Mou sulmoi Pep, pasi Reali i tij u eliminua në gjysmëfinalin e Ligës së Kampionëve nga Barcelona, skuadra që më pas do të fitojë trofeun.

#### Karlo Ançeloti

"Në historinë e 'Champions League' ka vetëm një klub dhe vetëm një trajner që kryesonin 3-0 në fund të pjesës së parë të finales, por nuk arritën të marrin trofeun". Kjo ishte mënyra me të cilën Hoze Murinjo komentoi humbjen e Milanit ndaj Liverpulit, në finalin e Ligës së Kampionëve, në vitin 2005 në Stamboll.

#### Klaudio Ranieri

"Është 70 vjeç (ishte 60) dhe ka fituar vetëm një Superkupë. Është shumë i vjetër për të ndryshuar mentalitet. Unë studiova pesë orë në ditë gjuhën italiane për të komunikuar me futbollistët, tifozët dhe gazetarët. Desha t'ju respektoja. Ranieri qëndroi pesë vjet në Angli, por ka ende vështirësi në të thënat "good morning" dhe "good afternoon". Nuk është faji im që kur shkova te Çells, në vitin 2004, më thanë se më kishin marrë sepse ishin të bindur se me Ranierin nuk do të fitonin kurrë". Kjo deklaratë është bërë në 8 maj 2010.

#### Zdenek Zeman

"Thotë për mua që jam një trajner mediokër? E respektoj mendimin e tij edhe pse nuk e njoh. Ku luan ky Zeman? Ah, qenka trajner nuk e dija. Tani jam me pushime, kur të kthehem do të shoh në "google" për të parë çfarë ka bërë ky person, çfarë ka fituar gjatë karrierës së tij". Në këtë mënyrë foli Murinjo për Zemanin, në Cyrih, në qershor 2012.

#### Rafa Benitez

Në këtë mënyrë e priti Murinjo zëvendësuesin e tij te Interi. "Një gjë është e sigurt: nuk do të bëj më mirë se mua. Edhe nëse fiton botërorin për klube do të ketë fituar 2 ndeshje. Unë fitova 13 ndeshje për ta çuar Interin deri aty. Edhe ai sukses do të jetë i imi, jo i atij". Pastaj, pas fitores të Interit në botërorin për klube shtoi. "Prisja një falënderim për suksesin që i dhashë. Pyesni tifozët e Interit se çfarë mendojnë për të dhe çfarë mendojnë për mua".

#### Sinisha Mihajloviç

"Trajneri i dytë i Interit është Beppe Baresi, por Mihajloviç flet për Interin më shumë se Baresi. Nuk e di përse një skuadër që i ka dhënë një mundësi të bëhet trajneri i dytë dikujt që i ka pështyrë në fytyrë një kundërshtari, nuk i jep një mundësi të dytë Adrianos apo Balotellit". Në këtë mënyrë foli Murinjo për Mihajloviçin, kur mbërriti te Interi, në vend të Roberto Mançini.

ATLETIKO PARALAJMËRON BARCELONËN PËR GRIZMANIN

# KLAUZOLA E LIRIMIT ËSHTË 200 MLN EURO

Gil Marin pranoi bashkimin e kësaj linje përpara, gjë që e bën të etur për të rinegociuar kontratën e Grizman, e cila zgjat deri në vitin 2022 dhe përmban një klauzolë lirimi prej 200 milionë eurosh deri në korrik të vitit të ardhshëm, kur do të bëhet 100 milionë euro

Manchester Junajtedi dhe Barcelona janë paralajmëruar se mund të kenë nevojë të spërkasin deri në 200 milionë euro për të blerë Antoine Grizman këtë verë. Atletiko Madrid raportoi në FIFA javën e kaluar për transferimin e dyshuar të yllit të Francës, pasi drejtori i "Camp Nou", Guillermo Amor, tha se presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, "pati një takim me familjen e Grizmanit". Futbollisti 26-vjeçar ishte i lidhur ngushtë me një lëvizje drejt Manchester para fillimit të këtij sezoni, por vendosi të qëndrojë me Atletikon. Trajneri i skuadrës, Diego Simeone, kohët e fundit ngriti

spekulime duke thënë se ai nuk do të qëndronte në rrugën e Grizman, nëse francezi dëshironte një sfidë të re, por shefi ekzekutiv i Atletiko, Miguel Angel Gil Marin, ka tingëlluar me një ton më luftarak. "Atletiko nuk dëshiron ta shesë Grizmanin tani, apo në verë. Për ne është një lojtar shumë i rëndësishëm, i cili është rritur shumë. Edhe ne jemi rritur me të. Synimi ynë është të vazhdojmë të rritemi të gjithë së bashku. Verën e kaluar kemi bërë një përpjekje përtej mundësive të klubit dhe do ta bëjmë përsëri verën e ardhshme. Largimi i Grizman nuk është në duart tona, por deri në verë është e pamundur të

na lërë", tha Dil Marin.

Atletiko do të jetë në gjendje për të rreshtuar Diego Kostan me Grizmanin në sulm, vitin e ri, pasi ndalimi i regjistrimit të lojtarëve nga FIFA-s të jetë hequr. Gil Marin pranoi bashkimin e kësaj linje përpara, gjë që e bën të etur për të rinegociuar kontratën e Grizman, e cila zgjat deri në vitin 2022 dhe përmban një klauzolë lirimi prej 200 milionë eurosh deri në korrik të vitit të ardhshëm, kur do të bëhet 100 milionë euro: "Deri më 1 korrik, klauzola e lirit të Griezmann është 200 milion euro", përfundoi shefi ekzekutiv i Atletiko, Miguel Angel Gil Marin.



Miguel Angel Gil Marin

**Atletiko nuk dëshiron ta shesë Grizmanin tani, apo në verë. Për ne është një lojtar shumë i rëndësishëm, i cili është rritur shumë. Edhe ne jemi rritur me të. Synimi ynë është të vazhdojmë të rritemi të gjithë së bashku. Verën e kaluar kemi bërë një përpjekje përtej mundësive të klubit dhe do ta bëjmë përsëri verën e ardhshme. Largimi i Grizman nuk është në duart tona, por deri në verë është e pamundur të na lërë**



## Shkëndija kërkon të "rrëmbejë" mbrojtësin e Tiranës

Shkup, 29 dhjetor - Shkëndija e Tetovës është një nga klubet më të pasura shqiptare në rajon, duke qenë se ka edhe investitorë të fuqishëm. Skuadra tetovare arriti të luante ndaj Milanit në "Europa League" dhe një gjë e tillë i shtoi edhe më shumë prestigjin. Kjo ka bërë që një pjesë e madhe e lojtarëve të kenë dëshirë të luajnë për këtë ekip edhe për shkak të pagesave të mira që ka. Kohët e fundit, tetovarët kanë shprehur interesimin e tyre duke nisur bisedime me klubin e Tiranës për të marrë shërbimet e Erion Hoxhallarit, mbrojtësit të krahut të majtë, bën të ditur "eduasportin.com". 22-vjeçari ka bërë paraqitje shumë të mira në kampin bardheblu dhe për këtë arsye presidenti Halili po mundohet që ta bindë të firmosë kontratën e re, që në rast shitjeje klubi të fitojë sa më shumë nga ky transferim. Por, Shkëndija e Tetovës në rast se do të dëshirojë vërtetë lojtarin, duhet që të paguajë në arkat e klubit bardheblu jo pak, por 250 mijë euro.

## VAR në Botërorin "Rusi 2018"

Teknologjia e re që u ka mundësuar arbitrave të ndeshjeve që gabojnë më pak është gati të zbarkojë edhe në kompeticionin ndërkombëtar më të rëndësishëm që do të startojë vitin e ardhshëm në Rusi që në muajin qershor. FIFA do të vendosë në mars nëse do të aplikojë ose jo VAR (Video Asistentin e Arbitrit). Lajmin e ka konfirmuar përgjegjësi i Komisionit të Arbitrave të Federatës Botërore, pikërisht legjendari i bilbilit, Pierluigi Kolina. "Është ende herët për ta thënë, por një vendim përfundimtar do të merret në mars. VAR është ende në një fazë eksperimentale, vendimi nisi në mars të vitit 2016 dhe duhet të zgjasë të paktën dy vite nga fillimi. Në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Ek-



zekutiv të IFAB, në mars, do të vlerësojmë rezultatet dhe do të vendosim nëse duhet konfirmuar menjëherë, nëse duhet zgjatur periudha e eksperimentimit, apo nëse duhet braktisur fare projekti, nëse do të

vlerësohet negativisht. VAR nuk jep një përgjigje përfundimtare, ofron një zgjidhje për gabimet e rënda që një arbitër mund të bëjë, por duhet të jetë e qartë, futbollit nuk është një lojë perfekt", deklaroi Kolina.

NIJAS LENA KONFIRMON LARGIMIN NGA TEUTA

## U NDAMË MIQËSISHT ME PRESIDENTIN!



Shkup, 29 dhjetor - Ndryshimi në stolin drejtues teknik te Teuta, ikja e Maganit dhe emërimi i Stavri Nicës, duket se do të sjellë edhe lëvizje në grupin e lojtarëve. Ky proces ka nisur me kapitenin Nijaz Lena, i cili nuk do të jetë më pjesë e "djemve të dedit", me të cilët luajti në dy periudha të karrierës së vet. Është vetë klubi durrsak, që e bën me dije një gjë të tillë. "Klubi dëshiron t'ju njoftojë se Nijaz Lena ka ndërprerë bashkëpunimin me KF Teuta dhe është larguar zyrtarisht", thuhet në komunikatën e klubit. Ndërkohë, vetë Lena flet pas zyrtarizimit të largimit nga bregdetarët durrsakë. "Pas një takimi me presi-

dentin e klubit, Edmond Hasanbelliu, me marrëveshje dhe në mënyrë miqësore vendosëm të ndërpres bashkëpunimin me klubin e Teutës. Për mua ka qenë nder të jem pjesë e Teutës, kjo ishte hera e dytë që luaja për këtë klub. Më vjen keq që nuk arritëm të bënim më mirë në këtë gjysmë kampionati. Uroj që klubi të dalë nga situata jo e mirë që po kalon dhe kam besim se do t'ia dalë. Faleminderit edhe tifozëve, që na kanë përkrahur në çdo ndeshje", deklaroi Lena. Cekim, 31-vjeçari nga Struga grumbulloi 17 ndeshje me "Djemtë e dedit", prej tyre dy në Kupën e Shqipërisë duke shënuar edhe dy gola.



**KOMUNA E BUTELIT**  
**Nr. 09-951/9 të datës 29.12.2017**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Butelit në vijim publikon:

**LAJMËRIM**

Lajmërohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të:

**PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE**

**Për Projektin arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore PN nr. 2.2, në pjesën nga PK nr. 1079/4, me qëllim G3 – Shërbime, në Bllokun 2 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup**

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore PN nr. 2.2, në pjesën nga PK nr. 1079/4, me qëllim G3 – Shërbime, në Bllokun 2 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup, me pozitën e saj gjendet në territorin e Komunës së Butelit. Sipërfaqja e shtrirjes projektuese është 700 m<sup>2</sup>.

Kufiri i përfshirjes projektuese është shfaqur me vijë, e cila i lidhë të gjitha pikat e thyeshme, e prezantuar me koordinatat përmes X dhe Y për secilën pikë të thyeshme, të shënuar me numra rendor prej T1 deri në T6 dhe të njëjtat janë dhënë në pasqyrën tabelore.

T1	7533487.4532	4654084.3689
T2	7533502.4900	4654047.5600
T3	7533485.0846	4654038.9845
T4	7533483.0659	4654044.1146
T5	7533474.4799	4654065.3181
T6	7533475.9155	4654073.3161

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e takimeve (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 05.01.2018 deri më 12.01.2018 (së paku pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël)

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrojnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të anketës publike është publikuar në Shtypin ditor Nova Makedonija dhe Koha, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore PN nr. 2.2, në pjesën nga PK nr. 1079/4, me qëllim G3 – Shërbime, në Bllokun 2 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup do të mbahet në lokalet e Komunës Butel, në Sallën për takime (Salla e vogël), më datë 10.01.2018, me fillim në ora 10:00.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Velimir Smilevski**



**KOMUNA E BUTELIT**  
**Nr. 09-505/8 e datës 29.12.2017**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Butelit në vijim publikon:

**LAJMËRIM**

Lajmërohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të:

**PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE**

**Për Projektin arkitektonik-urbanistik për bashkimin e PN 1.7 dhe 1.8 të formuara në PDU për çerekun e qytetit SSI 02, komuna e Butelit, me qëllim G2 (industria e lehtë dhe jondotëse) – halla për prodhimtari, KK Çair, Komuna e Butelit.**

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për bashkimin e PN 1.7 dhe 1.8 të formuara në PDU për çerekun e qytetit SSI 02, komuna e Butelit, me qëllim G2 (industria e lehtë dhe jondotëse) – halla për prodhimtari, KK Çair, Komuna e Butelit, me pozitën e saj gjendet në territorin e KK Çair të Komunës së Butelit. Përfshirja projektuese që është lëndë e këtij dokumentacioni kapë hapësirën me sipërfaqe prej 1824 m<sup>2</sup> (0,2 ha).

Kufiri i përfshirjes projektuese kapë PN 1.7, të definuar me këtë Projekt arkitektonik-urbanistik i ka koordinatat në vijim:

1	7.535.938.212	4.653.761.359
2	7.535.937.783	4.653.770.672
3	7.535.973.765	4.652.708.161
4	7.535.883.761	4.653.767.464
5	7.535.973.765	4.652.708.161
6	7.535.877.891	4.653.766.949
7	7.535.879.200	4.653.738.552
8	7.535.879.350	4.653.735.683
9	7.535.885.026	4.653.736.261
10	7.535.935.497	4.653.741.397
11	7.535.939.118	4.653.741.731

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e takimeve (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 05.01.2018 deri më 12.01.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrojnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të anketës publike është publikuar në Shtypin ditor Nova Makedonija dhe Koha, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për bashkimin e PN 1.7 dhe 1.8 të formuara në PDU për çerekun e qytetit SSI 02, komuna e Butelit, me qëllim G2 (industria e lehtë dhe jondotëse) – halla për prodhimtari, KK Çair, Komuna e Butelit do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën e takimeve (Salla e vogël) më datë 10.01.2018 me fillim në ora 11:00.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Velimir Smilevski**




shtojcë enigmatike e fundjavës

## FJALËKRYQI KLASIK

## HORIZONTALISHT

3. Këngëtari anglez, Kris
5. Futbollisti gjerman, Filip
7. Tinguj nga një zanore e nga një a më shumë bashkëtingëllore, që shqiptohen me një frymë
9. Mbushje me barut për gjuajtje me armë
10. Druri i Vitit të Ri
12. Filozofi rus, Karl
13. Astati
14. Mjet transporti pa motor, që tërhiqet nga një automjet
18. E bëj dikë të mos shohë fare, e verboj
20. Thaj
21. Tantali
22. Inicialet e autorit Pashku
24. Pohimi ynë
25. Dritat e komunikacionit
27. Kilon
28. Këngëtarja amerikane, Amos
29. Gaforret
32. Lodra, daullja
33. Këngëtari amerikan, Kuper
35. Shfaqet
37. Pemë tropikale
39. Përkund, lëkund
40. Pjesë e tultë e trupit
41. Shkop i trashë prej druri a prej hekuri, me kokë të madhe
42. Poeti kroat, Ujeviq
45. Fat në lojë
46. Njësi peshe për gurët e çmuar
49. Pjesë e syrit, iris.




## VERTIKALISHT


1. Pëlhurë stilistik
2. Rilindasi ynë Vasa
3. Skllav, i burgosur
4. Vargje kuranore
5. Pavarësia
6. Midis
8. I vogli i dhisë
9. Funkcion matematikor në kombinatorikë (!)
11. Iridiumi
12. Magjistër
15. Itriumi
17. Ar (frëngj.)
19. Lodh shumë, këput, kapit
23. Poeti shqiptar, Kote
24. Gaz i barkut me erë të keqe (sh.)
26. Fruit of Islam (shkurt.)
29. Libri i shenjtë musliman
31. Përkrahës i flaktë i një skuadre
32. Pjesë a sasi e caktuar, racion (bised. vjet.)
34. Një parafjalë
35. Idhull
36. Iriq (krahin.)
38. Ndajfolje pyetëse
43. Mjet për të rrëshqitur mbi borë
44. Baba
47. Tokë e punuar
48. Gazetari dhe moderatori Krasta.

## Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë





## DETEKSIONI

Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?




- kapësja
- libri
- luga
- dorëza
- shkopi i hokejit
- gotë
- krehëri
- unaza
- lapsi
- gozhdë
- bananja
- tundra
- këpuca
- copë e tortës

- nota muzikore
- furça e flokëve
- sabani
- flamuri
- shkopi i bejzbollit
- zarfi


## VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!



## LABIRINTI

Ndihmoni papagallit të arrijë deri te dhuratat e Vitit të Ri?




## ZBULIMI

Ngjyrosni fushat me pika që të zbuloni figurën!



## DALLIMET

Cilët janë 10 dallimet në fotografitë e mëposhtme!





# 15 GB 4G INTERNET OFERTË MAGJIKE PËR TËRË FAMILJEN

ME  
MAGENTA 1 M  
TË RE

NDAJI PËRJETIMET

## KY ËSHTË JU SJELL MË AFËR TË DASHURVE TUAJ



Dërgoni dhe pranoni para me Western Union



WESTERN UNION WU

moving money for better

MOBILE | ONLINE | AGENT LOCATION



UNIONI FINANCIAR SHKUP  
Tel: +389 2 3218 902  
www.ufs.com.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 ) , nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14 dhe 199/14), ndërsa në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv të Planit vjetor për punësim për vitin 2017 me nr. 12/6-2060/11 të datës 18.12.2017, NP "Parqet dhe gjelbërim" – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2017

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të pacaktuar të punës

1. NP "Parqet dhe gjelbërim" – Shkup ka nevojë për punësim të:

Table with 4 columns: Nr. rend, Shifra, Titulli vendit të punës, Nr. i realizuesve. It lists two positions: Vozitës i drejtorit and Vozitës të makinës.

- 2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës është për kohë të pacaktuar të punës.
3. Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës.
4. Secili kandidat duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Një mënyrë aktive të njëjshme maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendet e punës me numër rendor 1 dhe 2 duhet të përmbushin kushtet e posaçme sipas LMP ose Marrëveshjes kolektive për veprimtari komunale dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP "Parqet dhe gjelbërim" – Shkup; gjegjësisht

Kushtet e posaçme të caktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtari komunale për të gjithë personat ndihmës-teknik për të gjitha kategoritë janë:

- Kualifikimet profesionale:
- person ndihmës-teknik të nivelit të parë (A1), me nivel më të ulët të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërveçar,
- person ndihmës-teknik të nivelit të dytë (A2), me nivel më të ulët të kualifikimit III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm treveçar dhe

Përvojë pune, edhe atë: Për nivelin A1 së paku dy vjet përvojë pune Për nivelin A2 së paku një vit përvojë pune;

Kusht tjetër i posaçëm për vendin e punës me numër rendor 1 dhe 2 është edhe posedimi i kategorisë B.

6. Orari i punës është pesë ditë pune në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte) dhe do të jetë prej ora 7 deri në ora 15.

7. Neto pagesa themelore për vendin e punës me nr 1 është 19.355,00 denarë për orar të plotë të punës, ndërsa neto paga themelore për vendin e punës me nr. 2 është 18.865,00 denarë për orar të plotë të punës;

8. Kandidatët për punësim paraqiten në shpalljen publike përmes plotësimit të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk

9. Me fletëparaqitjen kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të paraqesin:

- Biografi të shkurtë
- Dëshmi për arsim të mbaruar (diplomë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinale ose kopje të vërtetuara në noter)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim për ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinale ose kopje të vërtetuara në noter)


10. Në pajtim me Planin vjetor për punësim në institucionin për vitin 2017, punësimet janë paraparë: 2 (dy) të nacionalitetit shqiptar.

11. Fletëparaqitjet së bashku me bashkëngjitjet dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP "Parqet dhe gjelbërim" – Shkup rr. "Ilinden" nr. 104; 1000 Shkup.

Kontakt tel. 02/3070 112 e-mail: covecki.resursi@parkovi.mk.com

Shpallja zgjatë 5 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të parregulluara nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

NP Parqet dhe gjelbërim UD drejtor, Ardijan Muça



Numër 04-3204/1 29.12.2017 SHKUP

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve në bazë të nenit 22, 23,24,25, 26 dhe 27 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gaz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë,nr. 62/05, 106/08,161/08,114/09,5130/090/10,124/10,47,11, 50/10,52/10,124/10,47/11,11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13,187/13,113/14,20/15,33/15,72/15, dhe 129/15) në lidhje me nenin 22 paragrafi (1) alineja 2 të Ligjit për punësim në sektorin publik (Gaz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë," nr. 27/14 dhe 199/14 dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në shërbimin profesional të komisionit shtetëror të zgjedhjeve nr. 01-1534/1 të datës 15.01. 2015, 01-2191/1 të datës 26.01.2016 dhe 01-219/3 të datës 09.02.201 shpall

SHPALLJE NUMËR 1/2017 PËR PUNËSIM TË 1(NJË) PËRMBARUESI NË KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE ME KOHË TË CAKTUAR DERI MË 31 DHJETOR 2018

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, shpall shpallje për punësimin 1( një) personi me anë të themelimit të marrëdhënies së punës me kohë të caktuar deri më 31 dhjetor 2018 për këtë vend pune:

1. Udhëheqës sektori , për kryerjen e punëve juridike, Sektori për çështje juridike dhe normative edukacion , të punëve administrativo-profesionale dhe marrëdhënie me opinionionin- një përmbarues

Kualifikimi i duhur :Shkenca juridike , së paku 240 kredi të përfuara sipas EKTs ose të mbaruar shkallën VIII/1 Përvojë pune : së paku katër vite në profesion prej të cilëve së paku një vit në vend udhëheqës në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion prej të cilëve së paku dy vjet në vend udhëheqës në sektorin privat.

Koha ditore e punës 8 orë (08:30-16:30), 40 orë në javë Rroga themelore neto 28.046,00 denarë

Më shumë informacione për detyrat e personit që do të punojë në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve për të cilin është shpallur shpallja mund të gjenden në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Shërbimin profesional të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, e cila është shpallur në linkun http:// www.sec.mk

Kandidatët e interesuar do të dorëzojnë :

- Fletëparaqitje të nënshkruar personalisht për vendin e punës për të cilin paraqitet;
- Biografi të shkurtër –CV me e obliguar shënimi i numrit të telefoni për kontakt dhe adresën ;
- Dëshmi për përvojë pune;
- Fotokopje e dëftësës (certifikatë) për mbarimin e shkallës së arsimimit për të cilën kërkohet vend pune dhe;
- Kopje të certifikatës së nënshtetësisë.

Dokumentacioni i duhur me zarf të mbyllur të dorëzohet në këtë adresë:

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE Bul., Shën Kirili dhe Metodi" nr.54 1000 Shkup (me shenjë ,, shpallje për punësim")

Për arsye të përshpejtimt të procedurës , fletëparaqitjet dorëzohen vetëm me anë të arkivit të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrohen në mënyrën e cekur dhe në afatin e konfirmuar, dhe të cilat nuk do të përmbajnë dokumentet e duhura do të llogariten si të dorëzuara jo në kohë dhe jo komplete dhe nuk do të shqyrtohen . Afati i dorëzimit të dokumentacionit të duhur është pesë(5) ditë duke e llogaritur edhe ditën kur është shpallur shpallja në Shtypin ditor . përkatësisht deri më 05.01.2018 (e premte) në ora 16:30.

Pas selektimit të fletëparaqitjeve, kandidatët të cilët e kanë dokumentacionin në rregull do të thirren në intervistë në selinë e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve,në afat të paraparë në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune do të kryejë zgjedhjen

Personi për kontakt: Gabriella Mihajlovska 02/3244-74 gabriela.mihajlovska@sec.mk

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE Sekretar i Përgjithshëm Dobre Jançev

UNIVERSITETI "Shën Kliment Ohridski" – Manastir UNIVERSITY "St. Kliment Ohridski" - Bitola

Faculty of Veterinary Science - Bitola Prilepska pn, Manastir 7000, Maqedoni Tel: +389 47228899, Faks: +389 47228899

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për Arsim sipëror të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/2010, 17/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015 dhe 20/2015) dhe nenit 29 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Sv. Kliment Ohridski" Manastir (Buletin nr. 348 të datës 03.05.2013), Fakulteti i veterinarisë – Manastir njësi në përbërje të Universitetit "Sv. Kliment Ohridski" – Manastir më datë 28.12.2017 publikon:

KONKURS PËR ZGJEDHJE TË 3 BASHKËPUNËTORËVE – ASISTENTËVE

Nga fusha shkencore 407- Mjekësia veterinarë për sferën në vijim:

- 1. 1 – Bashkëpunëtor – asistent nga sfera 40715 – Farmakologji dhe toksikologji 40734 – Të tjera
2. 2- Bashkëpunëtor – asistent nga sfera 40723 – Andrologjia dhe pllenimi artificial 40724 – Gjinekologji dhe obstetrikë me sterilitet 40734 – Të tjera

Nga fusha shkencore 503 – Shkencat ekonomike:

- 3. 3- Bashkëpunëtor – asistent nga sfera 50325 – Marketing 50329 – Ekonomika në veterinar 50323 – Ekonomika e ndërmarrjeve

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe kushtet e parapara në aktet e përgjithshme të Universitetit dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Sv. Kliment Ohridski" Manastir. Përvojë pune së paku prej 5 vjet në sferën përkatëse. Orari i punës: 8 orë në ditë, 40 orë në javë, orari është prej ditës së hënë deri ditën e premte, prej ora 08:00 deri në ora 16:00. Marrëveshje për punësim për kohë të caktuar prej 36 muaj, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune. Neto pagesa është 22.500,00 denarë. Së bashku me fletëparaqitjen për Konkursin kandidatët për bashkëpunëtorë – asistentë të dorëzojnë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter: Biografi; Diplomë për arsim të mbaruar përkatës nga sfera përkatëse shkencore me minimum 300 SETK; Certifikatë të lindjes; Certifikatë të shtetësisë; Deklaratë me shkrim të vërtetuar në noter me të cilën deklarohet se nuk ka punuar me organet e sigurisë shtetërore të periudhës të caktuar nga neni 2 paragrafi 1 të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përcaktim të kushtit të posaçëm për kryerje të funksionit publik (Gazeta Zyrtare 24 të datës 25.02.2011).

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit. Dokumenti parashtrohet deri në Fakultetin e veterinarisë – Manastir në rr. Prilepska pn, 7000 Manastir, Fahu BP 150 ose personalisht në lokalet e fakultetit në arkiv.

Fakulteti i veterinarisë – Manastir Prof. D-r Zhivko Gacovski

KORRIGJIMI I SHPALLJES PUBLIKE

Publikohet korrigjim i shpalljes publike për punësim të kuadrit mësimor dhe jomësimor nga SHFK "Vera Ciriviri Trena" të publikuar në Koha më datë 28.12.2017

Korrigjimi ka të bëjë me pikën 2. Mësimdhënës të kulturës klasike të civilizimit evropian (lëndë zgjedhore) – në arsim të nevojshëm duhet të qëndrojë: VII/1 – Mësimdhënës të studimeve të mbaruara klasike ose filologjia klasike, që ka fituar titullin Klasik i diplomuar ose filolog i diplomuar klasik ose mësimdhënës me grupe të mbaruar studimore Historia e artit me arkeologji;

Gjithashtu edhe në pikën 4. Mësimdhënës të gjuhës frënge me studime të mbaruara të gjuhës dhe letërsisë frënge – kuadri mësimor VII/1, Studime të mbaruara për gjuhë dhe letërsi frënge – drejtim tjetër të me përgatitje të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike në fakultetin përkatës VII/1

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), Dekani i Fakultetit juridik "Justiniani i Parë" në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

- Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore e drejta penale procesuese për kohë prej 5 /pesë/ vjet / /

Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e përgjithshme të fakultetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë: dëshmi, gjegjësisht vendim dhe/ose diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit – doktor i shkencave, deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, certifikatë të shtetësisë, biografi të shkurtër /CV/, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të punimeve.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9b – Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit. Informatat plotësuese në tel: 02/3117-244

Fakulteti juridik "Justiniani i Parë" në Shkup

Advertisement for Koha newspaper, including website URL, contact info, and images of the newspaper.

Advertisement for the University of "Shën Kirili dhe Metodi" - Shkup, Faculty of Economics.

Në bazë të nenit 131 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016 dhe 127/16), nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – teksti i pastruar ("Lajmëtarit universitar" nr. 274/13) dhe nenit 41 paragrafi 1 alineja 8, nga Rregullorja për marrëdhënie të brendshme dhe punën e Institutit ekonomik në Shkup në përbërje të Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodi" Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 130/2009 dhe 288/2014), drejtori i Institutit ekonomik publikon

KONKURS

Për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor

1. Publikohet konkurs për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, edhe fushën shkencore shoqërore, fusha shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment), sfera menaxhim me resurset njerëzore.

2. Kandidatët e paraqitur, krahas kushteve të përgjithshme, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt arsimor-shkencore, bashkëpunëtorë dhe arsimor –profesionale dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodi" Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjen në titujt arsimor-shkencore.

3. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe diplomë dhe/ose diplomë të arsimimit dhe biografi të shkurtër me të dhëna për punën e tyre shkencore profesionale. Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në arkiv të Institutit ekonomik ose me postë në adresë "Prolet" nr. 1, 1000 Shkup.

4. Pagesa dhe orari i punës janë të përcaktuara në aktet e Institutit ekonomik.

5. Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit. Informata shtesë mund të merren në telefonin 5220-104 ose në lokalet e Institutit ekonomik.

UNIVERSITETI "SHËN. KIRIL DHE METODI" INSTITUTI EKONOMIK SHKUP

## SHOQËRIMI ME GOMARË I SHËNDETSHËM!



Shoqërimi i të moshuarve me kafshët, po del të jetë e shëndetshme! Megjithatë, të ndajnë kohën me gomarë, u ndihmon edhe më shumë atyre në lehtësimin e stresit dhe gjendjes së tyre psikologjike të rënduar. Kështu rezulton

një studim nga Qendra Kryesore e Onkologjisë në Bristol, ndërsa thuhet se ka përfitime të qarta terapeutike nga kafshët nëse adaptohen në ndonjë shtëpi të moshuarish. "Shumë njerëz e kanë më të lehtë të kalojnë kohë me kafshë sesa me njerëz të komplikuar, kështu që për pacientët mund të jetë shumë paqësor ose përvoja e butë" thotë Trishtina Macnair, psikologe e kësaj qendre onkologjike. Sipas saj shoqërimi me gomarët, ka efekt drejtpërdrejt fizik dhe terapia e kafshëve ka treguar rezultate në uljen e presionit të gjakut. Ndërsa qentë dhe macet kanë kohë që janë marrë në shtëpitë e kujdesit ose spitalet - gomarët tani janë vizitorët më të zakonshëm të kafshëve.



## Dieta e ujit të vret

Nutricistët po shprehin shqetësime për një dietë të re të rrezikshme të modës, e cila ndalon konsumimin e çdo gjëje përveç ujit, çajit dhe kafesë. Dieta e ujit përfshin përpjekjen për të humbur peshën duke mos ngrënë ushqim dhe duke marrë vetëm tre pije. Trendi është bërë popullor në mediat sociale me mijëra njerëz duke përdorur hashtag #waterfast për të dokumentuar progresin e tyre dhe për të inkurajuar të tjerët të marrin pjesë. Por kritikët kanë paralajmëruar se kjo mund të jetë 'dieta më e rrezikshme ndonjëherë'.

## DY MIQ HETEROSEKSUALË MARTOHEN: KËSHTU EVITOJMË TAKSAT

Çfarë nuk bëhet për të mos paguar 50 mijë euro taksa. Një 83-vjeçar irlandez, Matt Murphy, i ka propozuar mikut të tij më të mirë, 58-vjeçarit Michael O'Sullivan, për t'u martuar në mënyrë që mund t'i linte shtëpinë pa u detyruar të dorëzonte shumë e kripur. Falë një referendumi të vitit 2015, martesat homoseksuale janë të lejuara në ishull. Nga këtu lindi ideja për të evituar taksën e ekzagjeruar. "E njoh Matty-n prej 30 vitesh, jemi bërë shumë miq pasi martesat ime e dytë mbaroi", shpjegoi O'Sullivan për Irish Mirror. Të dy kanë kaluar momente të vështira, si Michael që përfundoi duke jetuar në rrugë për disa kohë dhe Matt për shkak të një forme artriti që godet nervin optik. "Qëndrova tek ai për pak kohë, kur në një pikë Matt më tha 'pse nuk transferohesh këtu?', tregon Michael për fillimin e një bashkëjetese "të rastësishme dhe jo me kohë të plotë". Një prezencë fizike për të cilën 83-vjeçari ka gjithnjë e më shumë nevojë, por që nuk mund ta paguajë. Kështu i erdhi në mendje ideja t'i ofronte mikut shtëpinë në këmbim të ndihmës, në mënyrë që të ketë një shtëpi ku të jetojë, kur (O'Sullivan) të largohet nga jeta. Por problemi është se taksat për trashëgiminë e shtëpisë janë të larta,



një shifër prej 50 mijë eurosh, që do ta detyronin të shiste të njëjtën shtëpi për të paguar taksën. Kështu një mbrëmje "duke folur me një mikeshë, ajo duke bërë shaka tha se duhej të martoheshim" për ta zgjidhur këtë çështje. Po atë mbrëmje u bë propozimi, që u pranua. Martesa u celebrua në një ish-spital të Dublinit dhe më pas u organizua një darkë për pesë veta në një bar aty afër. "E dua Mattin, dhe ai më do mua, por si miq", tha O'Sullivan në fund të ceremonisë.



## NDIHMJA PËR FËMIJËT E HUAJ MUND TË RRIË BESIMIN TEK ADOLESHENTËT

Një studim i ri sugjeron për ngritjen e nivelit të besueshmërisë tek adoleshentët, e cila mund të ngritet pasi që ju mund ti ndihmoni fëmijët e huaj apo edhe familjarët e tyre dhe kjo gjë mund të ndikoj në rritjen e miqësisë tek adoleshentët. Në qoftë se, disa fëmijë vendas i zgjasin dorën disa të huajve për t'i ndihmuar, kjo gjë

mund të ndikojë në përmirësimin e vetëbesimit tek adoleshentët dhe të rrisin besimin, thuhet në këtë hulumtim. Ndërsa adoleshentët shfaqnin sjellje pozitive për shoqërim, si ndihmë, ndarje dhe ngushëllim ndaj të huajve, këta të fundit fitojnë një vetëbesim më të lartë. Autorja e këtij studimi Laura Padilla-Walker e cila është

profesoreshë në Universitetin Brigham Young në SHBA tha se ky studim na ndihmon për ta kuptuar më mirë se si të rinjtë ndihmojnë të huajt për marrëdhëniet e tyre shoqërore. Hulumtimi i botuar në Journal of Adolescence ka përfshirë 681 adoleshentë, 11-14 vjeç, në dy qytete amerikane.



KALENDARI HISTORIK 30 DHJETOR

1665 - "Mesia" Sabatai Zevi largohet nga Konstatinopojë.

1809 - Ndalohet vënia e maskave në balë në Boston.

1861 - Në SHBA ndërpritet pagesa e bankave me ari.

1893 - Rusia nënshkruan marrëveshje ushtarake me Francën.

1903 - Themelohet Shoqata amerikane e shkencave politike në Nju Orleans.

1922 - Bashkimi Sovjetik organizohet si federatë e Rusisë, Ukrainës, Bjellorusisë dhe Transkaukazisë.

1935 - Bombarduesit italianë kanë shkatërruar njësitin e Kryqit të Kuq suedez në Etiopi.

1947 - Republika shpallet republikë.

1949 - India njeh Republikën Popullore të Kinës.

1950 - Vietnam, Laosi dhe Kamboxhia shpallen shtete të pavarura nga Franca.

1993 - Vatikani njeh Izraelin.

2006 - Saddam Hussein ekzekutohet me varje.

Edhe pse ka qenë e njohur me prodhuesin më të njohur të telefonave mobil NOKIA dhe me sloganin e njohur "Connecting People", në Finlandë nuk mund të gjeni asnjë kabinë telefoni me pagesë.



Alfabeti më i gjatë në botë është ai kinez, i cili numëron 72 shkronja dhe gjithsej 105 simbole. Ndërsa ai më i shkurtër është alfabeti kamboxhian, gjithsej 7 shkronja.



### MIQTË E GOMARIT

Një fshatari i ngordh gomari. Shokët për ta tallur, i shkuan për vizitë...

Njeri i thotë: - Të rroni vetë!

Tjetri: - Ngushëllime

I fundit: - Si gomari dhe ju me radhë.

Në fund, duke kuptuar qëllimin e vizitës, fshatari ja kthen:

- Shumë faleminderit që erdhët, nuk e dija që gomari ime kishte kaq shumë shokë!

A E DINI SE...



BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Familje do të thotë: Askush nuk lihet pas, apo të harrohet.  
(David Ogden Stiers)